

VENDIM
Nr. 674, datë 10.11.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE (PMP) DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet mbrojtëse personale (PMP) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të PMP-së me kërkesat thelbësore të objektivave të shëndetit dhe sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Çdo PMP e vendosur në treg, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me vendimin nr. 1053, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara’”, nuk do të pengohet të bëhet e disponueshme në treg, pas hyrjes në fuqi të këtij rregulli. Certifikatat e lëshuara në përputhje me këtë vendim janë të vlefshme.

4. Vendimi nr. 1053, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLI TEKNIK
PËR PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE (PMP) DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Ky rregull teknik ka për qëllim përcaktimin e kushteve për projektimin dhe prodhimin e pajisjeve mbrojtëse personale (këtu e në vijim referuar si “PMP”) të vendosura në treg, në mënyrë që të garantohet shëndeti i përdoruesve, si dhe lëvizja e lirë në treg.

Neni 2

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloren (BE) 216/425, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 9 marsit 2016, “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”, që shfuqizon direktivën e Këshillit 89/686/KEE, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 81, datë 31.3.2016, faqe 51–91.

Fusha e zbatimit

1. Ky Rregull zbatohet për PMP-të.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për:
 - a) PMP-të e projektuara dhe të prodhuara për përdorim nga Forcat e Armatosura ose të ruajtjes së ligjit dhe rendit;
 - b) PMP-të për vetëmbrojtje, me përjashtim të PMP-ve që përdoren për aktivitete sportive;
 - c) PMP-të e projektuara dhe të prodhuara për përdorim privat përkundrejt:
 - i. kushteve atmosferike të një natyre joekstreme;
 - ii. lagështisë dhe ujit gjatë larjes së enëve;
 - d) PMP-të e përdorura veçanërisht në anije ose në avionë, që janë objekt i traktateve ndërkombëtare të zbatueshme në Shqipëri;
 - e) PMP-të e përdorura për mbrojtjen e kokës, fytyrës dhe syve të përdoruesve të motoçikletave dhe triçikleve.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllime të këtij Rregulli, do të zbatohen përkufizimet si vijon:

- a) “Pajisje Mbrojtëse Personale” është:
 - i. çdo pajisje e projektuar dhe e prodhuar për t’u veshur ose për t’u mbajtur nga një person për mbrojtje nga një ose më shumë rreziqe, në lidhje me shëndetin dhe sigurinë;
 - ii. komponentët e këmbëshëm të pajisjeve sipas pikës “a”, të cilat janë thelbësore për funksionet mbrojtëse;
 - iii. sistemet lidhëse për pajisjen, e përmendur në pikën “a”, që nuk mbahen ose vishen nga një person, që janë projektuar të lidhin atë pajisje me një mjet të jashtëm apo me një pikë të qëndrueshme mbështetjeje (ankorim), të cilat nuk janë projektuar të jenë gjithmonë të fiksuara dhe që nuk kërkojnë punime për fiksimin e tyre përpara përdorimit;
- b) “Bërje e disponueshme në treg” nënkupton furnizimin e PMP-ve për shpërndarje ose përdorim gjatë një veprimtarie tregtare me ose pa pagesë;
- c) “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme, për herë të parë, e PMP-ve në treg;
- ç) “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një PMP ose e projekton apo prodhon dhe e tregon nën emrin apo markën e tij tregtare;
- d) “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi, për të vepruar në emër të tij, për detyra specifike;
- dh) “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar PMP nga një vend tjetër;
- e) “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit dhe importuesit, që bën të disponueshëm PMP-të në treg;
- ë) “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi dhe shpërndarësi;
- f) “Specifikim teknik” është dokumenti, ku përshkruhen kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga PMP-të;
- g) “Standard shqiptar i harmonizuar” është një standard shqiptar që ka adoptuar një standard evropian të harmonizuar, në mbështetje të legjislacionit përkatës dhe të rregullave teknike. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare;
- gj) “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit;
- h) “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin;

i) “Vlerësim i konformitetit” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë për PMP-të e parashikuara nga ky rregull;

j) “Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin;

k) “Kthim i produktit” është çdo masë për kthimin mbrapsht të PMP-së, që është bërë ndërkohë i disponueshëm te përdoruesi i fundit;

l) “Ndalim i tregimit” është çdo masë për të parandaluar PMP-të në zinxhirin e furnizimit, nga bërja e disponueshme e tij në treg;

ll) “Markim CE” është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që PMP-ja është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

Neni 4

Bërja e disponueshme në treg

PMP-ja bëhet e disponueshme në treg nëse, kur mirëmbahet në mënyrën e duhur dhe përdoret sipas qëllimit të përdorimit, është në përputhje me këtë Rregull dhe garanton sigurinë e përdoruesve, pa cenuar shëndetin ose sigurinë e njerëzve, kafshëve shtëpiake ose pronës.

Neni 5

Kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë

PMP-të duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të aplikueshme për to, sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij Rregulli.

Neni 6

Dispozitat lidhur me përdorimin e PMP-ve

Kërkesat e mëparshme, lidhur me përdorimin e PMP-ve, janë të zbatueshme nëse nuk prekin projektimin e PMP-ve që janë vendosur në treg në përputhje me këtë Rregull.

Neni 7

Lëvizja e lirë

1. Në territorin shqiptar nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg e PMP-ve të cilat janë në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli.

2. Nuk pengohet paraqitja në panairë tregtare, ekspozita apo demonstrime të ngjashme me to e PMP-së që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli, me kushtin që një shënim qartësisht i dukshëm tërheq vëmendjen për këtë dhe që ajo nuk mund të jetë e disponueshme në treg deri sa të sillet në përputhje me të gjithë kërkesat e këtij Rregulli.

3. Gjatë demonstrimit duhen marrë masat e përshtatshme që garantojnë mbrojtjen e personit.

KREU II

DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 8

Detyrimet e prodhuesit

1. Kur prodhuesi vendos në treg PMP-në ai siguron se ajo është projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, të parashikuara në shtojcën e II të këtij Rregulli.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të parashikuar në shtojcën III (“dokumentacioni teknik”) dhe kryen ose kërkon kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit, parashikuar në

nenin 19 të këtij Rregulli.

Kur nëpërmjet procedurave të përshtatshme demonstron përpunueshmëria e PMP-së me kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit, parashikuar në nenin 15 të këtij Rregulli, dhe vendos/fikson markimin CE të konformitetit, parashikuar nga neni 16 i këtij Rregulli.

3. Prodhuesit mbajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet, pasi kanë vendosur PMP në treg.

4. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat, që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me këtë Rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e PMP-ve dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose kombëtare ose në specifikimet teknike, sipas të cilave është deklaruar përpunueshmëria e PMP-ve, të merren parasysh.

Në rastet kur PMP-të nuk përputhen me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe është e përshtatshme, në lidhje me risqet që paraqet një PMP, prodhuesi, kryen testime të mostrave të PMP-ve të tregtuara, heton dhe nëse është e nevojshme mban një regjistër ankesash për PMP-të jo në konformitet dhe PMP-të e kthyer nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

5. Prodhuesi siguron se PMP-ja që ka vendosur në treg mban një numër tipi, grupi apo serie ose elemente të tjera që lejojnë identifikimin e saj ose, kur madhësia apo natyra e PMP-ve nuk e lejojnë diçka të tillë, informacioni i kërkuar jepet në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të PMP-ve.

6. Prodhuesi vendos në PMP emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në PMP, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit. Adresa jepet në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e fundit dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

7. Prodhuesi siguron që PMP-ja të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin, të parashikuar në pikën 1.4, të shtojcës II, në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit. Udhëzimet, informacionet, si edhe etiketimet, duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të lexueshme.

8. Prodhuesi shoqëron PMP-në me deklaratën EU të konformitetit ose vendos tek udhëzimet dhe informacionet e përcaktuara në pikën 1.4, të shtojcës II, adresën e internetit në të cilën mund të gjendet deklarata EU e konformitetit.

9. Prodhuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se PMP-ja që ai ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë Rregull, duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme korrigjuese për të sjellë PMP-në në përputhshmëri; për kthimin e saj nga tregu ose për ndalimin e tregtimit të saj. Për më tepër, kur PMP-ja paraqet një rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërpunueshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

10. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse, prodhuesi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm (në formë shkresore ose në formë elektronike), në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë, për të demonstruar përpunueshmërinë e produktit me kërkesat ligjore përkatëse. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga PMP-të e vendosura në treg prej tij.

Neni 9

Përfaqësuesi i autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në nenin 8, pika 1, dhe përgatitja e dokumentacionit teknik, përcaktuar në nenin 8, pika 2, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryejë, të paktën, detyrimet si më poshtë:

a) të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për një periudhë 10-vjeçare, pasi PMP-ja është vendosur në treg;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në rast kërkesë nga ana e saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e konformitetit të PMP-së;

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse, sipas një kërkesë të bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve që paraqet produkti, për të cilin i është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 10

Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm PMP-të, në përputhje me këtë Rregull dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Përpara vendosjes në treg të PMP-së, importuesi siguron se prodhuesi:

a) ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në nenin 19, të këtij Rregulli;

b) ka përgatitur dokumentacionin teknik;

c) PMP-ja mban markimin CE të konformitetit dhe shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar dhe se;

d) ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 8 të këtij Rregulli.

Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se PMP-ja, të cilin ai e importon, nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II, importuesi nuk duhet të vendosë në treg PMP-në deri në momentin që PMP-ja përmbush kërkesat e këtij rregulli teknik. Importuesi informon menjëherë prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në rast se produkti paraqet rrezik.

3. Importuesi vendos në PMP emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet. Të dhënat mbi adresën duhet të jepen në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në PMP, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të PMP-së.

4. Importuesi siguron që PMP-ja shoqërohet nga udhëzimet, si dhe nga informacioni sipas pikës 1.4, të shtojcës II, të cilat janë në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit.

5. Importuesi siguron se gjatë kohës që produkti është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e PMP-së me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, të parashikuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij Rregulli.

6. Në rastet kur vlerësohet e përshtatshme, në lidhje me risqet që paraqet një PMP, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, importuesi duhet të kryejë teste të mostrave të PMP-së që ka bërë të disponueshme në treg, të hetojë, dhe nëse është e nevojshme, të mbajë një regjistër ankesash për PMP-të jo në konformitet dhe atyre të tërhequra nga tregu, duke mbajtur të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të kryer.

7. Importuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se PMP-ja, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë Rregull, merr menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për të sjellë PMP-në në përputhshmëri, të ndalojë tregtimin ose ta tërheqë atë nga tregu, nëse është e nevojshme. Kur PMP-ja shfaq rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për masat korrigjuese të marra.

8. Importuesi duhet që për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të PMP-së, të mbajë një kopje të deklaratës EU të konformitetit në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe dokumentacionin teknik, sipas kërkesës së kësaj strukture.

9. Importuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e PMP-së, në formë shkresore ose në formë elektronike, në gjuhën shqipe, ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga kjo strukturë. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga PMP-ja e vendosur në treg prej tij.

Neni 11

Detyrimet e shpërndarësit

1. Kur PMP-të bëhen të disponueshme në treg, shpërndarësit duhet të veprojnë me kujdesin e duhur, në lidhje me kërkesat e parashikuara nga ky Rregull.

2. Përpara bërjes së disponueshme të PMP-së në treg, shpërndarësi verifikon që PMP-ja:

a) mban markimin CE të konformitetit;

b) produkti është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar dhe udhëzimet e informacionin, sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij Rregulli, në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë plotësuar kërkesat, në përputhje me pikat 5 dhe 6, të nenit 8 dhe pikën 3, të nenit 10 të këtij Rregulli.

Kur një shpërndarës vlerëson ose ka arsye për të besuar se PMP-ja nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të zbatueshme për sigurinë dhe shëndetin, të parashikuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij Rregulli, nuk duhet ta bëjë PMP-në të disponueshme në treg, deri sa produkti të silllet në përputhshmëri me këtë Rregull. Kur PMP-ja shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Shpërndarësi siguron se gjatë kohës kur PMP-ja është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit apo të transportimit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat kryesore të zbatueshme për sigurinë dhe shëndetin, të parashikuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij Rregulli.

4. Shpërndarësi, i cili vlerëson ose ka arsye për të besuar se PMP-ja, të cilin ai e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk është në përputhje me këtë Rregull, siguron, nëse është e nevojshme, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e PMP-së në përputhshmëri/konformitet, e tërheq PMP-në ose kthen atë. Në rast kur PMP-ja paraqet rrezik, shpërndarësi informon menjëherë autoritetet kompetente për detajet në veçanti mbi mospërputhshmërinë dhe masat korrigjuese të marra.

5. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në formë shkresore ose elektronike, për të demonstruar përputhshmërinë e PMP-së. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse, sipas kërkesës së saj, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga PMP-ja e bërë e disponueshme në treg prej tij.

Neni 12

Rastet kur detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesit dhe shpërndarësit

Importuesi dhe shpërndarësi konsiderohen si prodhues, për qëllim të këtij Rregulli, dhe i nënshtrohen detyrimeve të parashikuara në nenin 8, kur ai vendos PMP në treg nën emrin ose nën markën e tij tregtare, ose modifikon PMP-të e vendosura në treg, në mënyrë të tillë që të preket përputhshmëria me kërkesat e parashikuara nga ky Rregull.

Neni 13

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Për PMP-të e përdorura sipas këtij Rregulli, operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, identifikojnë:

a) çdo operator ekonomik i cili e ka furnizuar atë me PMP;

- b) çdo operator ekonomik të cilit ai i ka furnizuar me PMP.
2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje që të paraqesin informacionin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, për 10 vjet pasi janë furnizuar me PMP dhe për 10 vjet pasi kanë furnizuar me PMP.

KREU III KONFORMITETI I PMP-ve

Neni 14

Prezumimi i konformitetit të PMP-ve

PMP-të që janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën II, të këtij Rregulli, të mbuluara nga ato standarde ose pjesë të tyre.

Neni 15

Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është treguar përmbushja e kërkesave thelbësore që lidhen me shëndetin dhe sigurinë, të përcaktuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij rregulli.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në shtojcën IX. Ajo përmban elementet e specifikuar në modulet e përcaktuara në shtojcat IV, VI, VII dhe VIII të këtij Rregulli, dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kërkuar nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për PMP-të e vendosura në tregun shqiptar.

3. Kur PMP-ja është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, hartohet një deklaratë EU konformiteti e vetme. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e PMP-së me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregull.

Neni 16

Parimet e përgjithshme të markimit CE

Markimi CE iu nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 17

Rregullat dhe kushtet për fiksimin e markimit CE

1. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në PMP ose kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së PMP-së, në paketim ose në dokumentet shoqëruese.

2. Markimi CE fiksohet përpara se PMP-ja të vendoset në treg.

3. Për PMP-të e kategorisë III, markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit të organit të notifikuar, që është përfshirë në procedurat e parashikuara në shtojcat VII ose VIII, bashkëlidhur këtij Rregulli.

Numri i identifikimit të organit të notifikuar vendoset nga vetë ai ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

4. Markimi CE, dhe në rastet e parashikuara, numri i identifikimit të organit të notifikuar shoqërohen nga një piktogram apo shenja të tjera që tregojnë rrezikun ndaj të cilit të mbron PMP-ja.

5. Strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, me mbështetjen edhe të autoriteteve doganore, sigurojnë aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmarrin veprimet e duhura në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

KREU IV PROCEDURA E KONFORMITETIT

Neni 18

Kategoritë e rreziqeve të PMP-ve

PMP-të do të klasifikohen sipas kategorive të rrezikut të parashikuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtij Rregulli.

Neni 19

Procedurat e vlerësimit të konformitetit

1. Procedurat e vlerësimit të konformitetit, sipas kategorive të rrezikut, të parashikuara në shtojcën I, janë si më poshtë:

a) **Kategoria I:** kontrolli i brendshëm i prodhimit (moduli A), sipas shtojcës IV bashkëlidhur këtij rregulli;

b) **Kategoria II:** ekzaminimi EU i tipit (moduli B), sipas shtojcës V bashkëlidhur këtij rregulli, ndjekur nga konformiteti me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit (moduli C), sipas shtojcës VI bashkëlidhur këtij Rregulli;

c) **Kategoria III:** ekzaminimi EU i tipit (moduli B), sipas shtojcës V bashkëlidhur këtij Rregulli, ose një nga:

i. konformiteti me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus kontrole të mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme (moduli C2), sipas shtojcës VII bashkëlidhur këtij rregulli;

ii. konformiteti me tipin bazuar në garantimin e cilësisë së procesit të prodhimit (moduli D), sipas shtojcës VIII bashkëlidhur këtij rregulli.

2. Në raste përjashtimore, procedurat e parashikuar në pikën “b” zbatohen për PMP-të e prodhuara si një copë e vetme, të përshtatshme për përdorim individual dhe që klasifikohen sipas kategorisë së III.

KAPITULLI V MIRATIMI I ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Neni 20

Miratimi i organeve të vlerësimit të konformitetit

1. Procedura e miratimit të organeve të autorizuar për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të palëve të treta, sipas këtij Rregulli, është ajo e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Në parashikimet në vijim të këtij Rregulli, termi “organ” nënkupton një organ të notifikuar (evropian) ose një organ të miratuar shqiptar, i cili është miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, për çdo rast.

Neni 21

Autoriteti miratues

1. Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit, në kuptim të këtij Rregulli.

2. Ministri përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, vepron si autoritet miratues, i ngarkuar me detyrën për krijimin dhe realizimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të miratuara, përfshirë pajtueshmërinë me nenin 26 të këtij rregulli.

Neni 22

Kërkesat për autoritetin e miratimit

Ministri përgjegjës për tregtinë, që vepron si autoritet miratimi, vepron sipas parimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 23

Detyrimi për informim i autoritetit miratues

Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit dhe mban të përditësuar listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit, fushat për të cilat janë miratuar, periudhën e vlefshmërisë dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 24

Kërkesat për organet e miratuara

1. Për qëllim miratimi, një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 11 të këtij neni.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit krijohet dhe është person juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Organi i vlerësimit të konformitetit është një organ, palë e tretë, e pavarur nga organizata ose PMP-ja që vlerëson.

Organi që i përket një shoqate biznesi ose federate profesionale, që përfaqëson sipërmarrjet e përfshira në projektim, prodhim, ofrim, montim, përdorim ose mirëmbajtje të pajisjeve që vlerëson, me kushtin që të tregohet pavarësia dhe mungesa e një konflikti interesi, mund të konsiderohet një organ i tillë.

4. Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit nuk do të jetë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i PMP-ve që ata vlerësojnë, as përfaqësuesi i njëres prej këtyre palëve. Kjo nuk pengon përdorimin e PMP-ve të vlerësuara që janë të nevojshme për veprimtaritë e organit të vlerësimit të konformitetit ose përdorimit të këtyre PMP-ve për qëllime personale.

Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyra të vlerësimit të konformitetit nuk përfshihen direkt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e këtyre PMP-ve, ose nuk përfaqëson palët e përfshira në këto veprimtari. Ata nuk përfshihen në veprimtari që mund të jetë në konflikt me pavarësinë e gjyqimit të tyre ose integritetin, në lidhje me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit për të cilat janë miratuar. Kjo vlen në veçanti për shërbimet e konsulencës. Organet e vlerësimit të konformitetit sigurohen që veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tyre të mos prekin konfidencialitetin, objektivitetin ose paanshmërinë e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit.

5. Organet e vlerësimit të konformitetit dhe stafi i tyre kryejnë veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën e kërkuar teknike në fushën specifike dhe çlirohen nga çdo presion dhe shtysë, sidomos financiare, që mund të ndikojë gjykimin e tyre ose rezultatet e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit, sidomos, në lidhje me personat ose grupet e personave që kanë interes në rezultatet e këtyre veprimtarive.

6. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë i aftë që të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit, që i caktohen nga shtojcat V, VII dhe VIII, bashkëlidhur këtij Rregulli dhe, në lidhje me të cilat është miratuar, qoftë nëse këto detyra kryhen nga vetë organi i miratuar, qoftë nëse kryhen në emër të tij apo nën përgjegjësinë e tij

Gjithmonë, dhe për çdo procedurë të vlerësimit të konformitetit, dhe çdo lloj ose kategori të PMP-së, në lidhje me të cilat është miratuar, organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë në dispozicion:

a) stafin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit;

b) përshkrimet e procedurave në përputhje me të cilat është kryer vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e riprodhimit të këtyre procedurave. Duhet të kenë politika dhe procedura të përshtatshme, në të cilat bëhet dallimi midis detyrave që kryen si organ i miratuar dhe veprimtarive të tjera;

c) procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive të cilat duhet të marrin parasysh madhësinë e sipërmarrjes, sektorin ku vepron, strukturën, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së PMP-së në fjalë dhe natyrën e prodhimit në masë apo në seri të procesit të prodhimit.

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer detyrat teknike dhe administrative, që lidhen me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit në mënyrën e duhur, dhe ka akses në të gjitha pajisjet ose shërbimet e nevojshme.

7. Staf i përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit duhet të ketë sa më poshtë:

a) trajnim të mirë teknik dhe profesional që mbulon të gjitha veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, në lidhje me të cilat është miratuar organi i vlerësimit të konformitetit;

b) njohuri të kënaqshme për kërkesat e vlerësimeve që kryejnë dhe autoritet të mjaftueshëm për të kryer këto vlerësime;

c) njohuri të mjaftueshme dhe aftësi për të kuptuar kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, të përcaktuara në shtojcën II, standardet e harmonizuara të zbatueshme dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian dhe të legjislacionit kombëtar;

ç) aftësi për të hartuar certifikata, të dhëna dhe raporte që tregojnë se vlerësimi është kryer.

8. Duhet të garantohet paanshmëria e organeve të vlerësimit të konformitetit, nivelit të lartë drejtues të tyre dhe stafit përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit.

Shpërblimi i nivelit të lartë drejtues dhe stafit përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të një organi vlerësimi të konformitetit, nuk duhet të varet nga numri i vlerësimeve të kryera apo nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

9. Organet e vlerësimit të konformitetit duhet të kenë mbulimin me siguracion, përveçse kur ky mbulohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose vetë ministria është direkt përgjegjëse për vlerësimin e konformitetit.

10. Staf i një organi vlerësimi të konformitetit respekton sekretin profesional, në lidhje me të gjithë informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre, sipas shtojcave V, VII dhe VIII bashkëlidhur këtij Rregulli, ose çdo dispozite të legjislacionit kombëtar në fuqi, përveçse kur bëhet fjalë për organet kompetente ligjzbatuese. Të drejtat e pronësisë mbrohen.

11. Organet e vlerësimit të konformitetit marrin pjesë ose sigurohen që stafi i tyre përgjegjës, për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit, të informohet për veprimtaritë përkatëse të standardizimit.

Neni 25

Prezumimi i konformitetit të organeve

Kur organi i vlerësimit të konformitetit plotëson kriteret e përcaktuara në standardet e

harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në *Fletoren Zyrtare*, do të prezumohet se është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 24 të këtij Rregulli, për sa kohë që standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Neni 26

Degët dhe nënkontraktimi nga organet e miratuara

1. Kur një organ i miratuar nënkontraktin detyra specifike, që lidhen me vlerësimin e konformitetit ose i drejtohet një dege të tij për kryerjen e tyre, ai duhet të sigurojë që nënkontraktori ose dega të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 24 dhe duhet të informojë autoritetin miratues në mënyrë të përshtatshme.

2. Organet e miratuara marrin përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët ose degët e tyre, kudo që ato janë themeluar.

3. Aktivitetet mund të nënkontraktohen ose të kryhen nga një degë vetëm me marrëveshje me klientin.

4. Organet e miratuara duhet të mbajnë në dispozicion të autoritetit miratues dokumentet përkatëse, në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktuesit ose degës dhe punën e kryer nga ata, në përputhje me shtojcat V, VII dhe VIII, bashkëlidhur këtij Rregulli.

Neni 27

Aplikimi për miratim

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të paraqesë një kërkesë për miratim tek autoriteti miratues, në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 28

Ndryshime në miratim

1. Kur ministri përgjegjës ka dyshime ose informohet se një organ i miratuar nuk i përmbush më kërkesat e miratimit, ose nuk përmbush më detyrimet e tij, atëherë ai, sipas rastit dhe në varësi të shkallës së mospërmbushjes së kërkesave ose detyrimeve, pezullon ose anulon miratimin.

2. Në rast pezullimi ose anulimi të miratimit, ose kur organi i miratuar ka pushuar veprimtarinë e tij, ministri përgjegjës merr masat e duhura për të siguruar që dosjet t'i kalojnë një organi tjetër të miratuar ose, sipas rastit, të mbahen në dispozicion të ministrit ose strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Neni 29

Detyrimet operacionale të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara duhet të kryejnë vlerësimet e konformitetit në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit të parashikuara në shtojcat V, VII dhe VIII, bashkëlidhur këtij rregulli.

2. Vlerësimet e konformitetit duhet të kryhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomikë. Organet e vlerësimit të konformitetit kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin vepron, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së PMP-së në fjalë dhe natyrën e procesit të prodhimit në masë apo në seri. Megjithatë, ata duhet të respektojnë shkallën e saktësisë dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar për pajtueshmërinë e PMP-së me këtë Rregull.

3. Kur një organ i miratuar zbulon se kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, të përcaktuara në shtojcën II, të bashkëlidhur këtij Rregulli, ose standardet përkatëse shqiptare të harmonizuara, ose specifikimet e tjera teknike nuk janë plotësuar nga një prodhues, ai duhet të

kërkojë që prodhuesi të marrë masat e duhura korigjuese dhe nuk duhet të lëshojë certifikatë apo vendim miratimi.

4. Kur, gjatë monitorimit të konformitetit, pas lëshimit të certifikatës apo vendimit të miratimit, një organ i miratuar konstaton se një PMP nuk është më në përputhje me kërkesat, ai duhet të kërkojë nga prodhuesi që të marrë masat e duhura korigjuese dhe duhet të pezullojë ose tërheqë certifikatën ose vendimin e miratimit, nëse është e nevojshme.

5. Kur nuk ndërmerren masa korigjuese ose ato nuk kanë efektin e kërkuar, organi duhet të kufizojë, pezullojë ose tërheqë certifikatat apo vendimet e miratimit, sipas rastit.

Neni 30

Ankimi kundër vendimeve të organeve të miratuara

Organet e miratuara duhet të kenë të rregulluar procedurën e ankimimit ndaj vendimeve të tyre. Organi i miratuar informon ministrinë në lidhje me çfarëdo ankesë të pranuar dhe mënyrën se si ajo është zgjidhur.

Neni 31

Detyrim i informacionit nga organet e miratuara

1. Organet e miratuara duhet të informojnë autoritetin miratues, për sa më poshtë:

- a) çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje të një certifikate apo vendim miratimi;
- b) çdo rrethanë që ndikon në fushëveprimin ose kushtet e miratimit;
- c) çdo kërkesë për informacion që kanë marrë nga strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, lidhur me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;
- ç) sipas kërkesës, aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, të kryera brenda fushës për të cilën janë miratuar, dhe çdo aktiviteti tjetër të kryer, duke përfshirë aktivitetet ndërkufitare dhe nënkontraktimin.

2. Organet e miratuara duhet t'ju japin organeve të tjera të miratuara sipas këtij rregulli teknik, që kryejnë aktivitete të ngjashme të vlerësimit të konformitetit, që mbulojnë të njëjtat PMP, informacion domethënës për çështjet që kanë të bëjnë me rezultatet negative dhe, sipas kërkesës, të rezultateve pozitive të vlerësimit të konformitetit.

KREU VI

MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I PMP-ve QË VENDOSEN NË TREG

Neni 32

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i PMP-ve që vendosen në treg

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i PMP-ve që vendosen në treg bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 33

Procedura për trajtimin e PMP-ve që paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut vlerëson se një PMP që mbulohet nga ky rregull paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, duhet të kryejë, për PMP-në në fjalë, një vlerësim i cili duhet të mbulojë të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregull. Operatorët përkatës ekonomik bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim.

2. Kur gjatë vlerësimit të parashikuar në paragrafin 1, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se PMP-ja nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë Rregull, pa vonesë i kërkon operatorit ekonomik përkatës që të marrë masat e duhura korigjuese për ta sjellë PMP-në

në përputhje me këto kërkesa, për ta ndaluar tregtimin, ose për ta kthyer brenda një kohe të arsyeshme, në raport me natyrën e riskut.

3. Strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut duhet të informojnë organin e vlerësimit të konformitetit përkatës në mënyrë të përshtatshme.

4. Masat korrigjuese, të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, merren në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

5. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave të duhura korrigjuese, në lidhje me PMP-në që ka vënë në dispozicion në treg.

6. Kur operatori ekonomik, nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së referuar në paragrafin 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar bërjen e disponueshme në treg të PMP-së, për ta tërhequr nga tregu ose për ta kthyer PMP-në.

Neni 34

PMP-të në përputhje me këtë rregull që paraqesin rrezik

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, pas vlerësimit të bërë sipas nenit 33, pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Rregulli, konstaton se edhe pse PMP-ja është në përputhje me këtë Rregull, ai paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, i kërkon operatorit përkatës ekonomik marrjen e masave të duhura për të siguruar që PMP-ja në fjalë, kur të vendoset në treg, të mos paraqesë rrezik, ta tërheqë atë nga tregu ose nga konsumatori, brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut të paraqitur.

2. Operatori ekonomik siguron që të ndërmerren veprime korrigjuese, në lidhje me të gjitha PMP-të në fjalë, që ai ka bërë të disponueshme në treg.

Neni 35

Mospërputhja formale

1. Pa përjashtuar parashikimet e nenit 33 të këtij Rregulli, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i kërkon operatorit përkatës ekonomik të sjellë PMP-në në përputhje, kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

- a) markimi CE është fiksuar në shkelje të nenit 17 të këtij Rregulli;
- b) markimi CE nuk është fiksuar;
- c) numri i identifikimit të organit të notifikuar, kur ky organ është i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit, është vendosur në kundërshtim me nenin 17 të këtij Rregulli ose nuk është vendosur;
- ç) deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar;
- d) deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar me saktësi;
- dh) dokumentacioni teknik ose nuk është në dispozicion ose nuk është i plotë;
- e) informacioni i përmendur në nenin 8, pika 6, ose neni 10, pika 3 mungon, është i rremë ose i paplotë;
- f) çdo kërkesë tjetër administrative e parashikuar në nenin 8 ose nenin 10, nuk është përmbushur.

2. Kur mospërputhja formale vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose parandaluar vënien në dispozicion të PMP-së në treg ose siguron që, të ndalohet tregtimi apo të kthehet PMP-ja nga tregu.

Neni 36

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e kërkesave të këtij Rregulli nga operatorët ekonomikë trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

KATEGORITË E RISKUT TË PMP-ve

Ky aneks parashtron kategoritë e riskut ndaj të cilave PMP-të synojnë të mbrojnë përdoruesit.

Kategoria I

Kategoria I përfshin në mënyrë ekskluzive risqet minimale të mëposhtme:

- a) dëmtim mekanik sipërfaqësor;
- b) kontakt me materiale pastrimi me aksion të dobët ose kontakt të zgjatur me ujin;
- c) kontakt me sipërfaqe të nxehta jo më shumë se 50 °C;
- d) dëmtim të syve nga ekspozimi në dritën e diellit (përveç rastit të vëzhgimit të diellit);
- e) kushte atmosferike që nuk kanë natyrë ekstreme.

Kategoria II

Kategoria II përfshin risqe të ndryshme nga ato të përmendura në kategoritë I dhe III;

Kategoria III

Kategoria III përfshin në mënyrë ekskluzive risqe që mund të shkaktojnë pasoja shumë të rënda, si vdekja ose dëmtimi i parikuperueshëm ndaj shëndetit, në lidhje me sa më poshtë:

- a) substanca dhe përzierje që janë të rrezikshme për shëndetin;
- b) atmosferë me mungesë oksigjeni;
- c) agjentë të dëmshëm biologjikë;
- d) rrezatim jonizues;
- e) mjedise me temperaturë të lartë, pasojat e të cilës janë të krahasueshme me ato të temperaturës së ajrit të paktën 100 °C;
- f) mjedise me temperaturë të ulët, pasojat e të cilës janë të krahasueshme me ato të temperaturës së ajrit - 50 °C ose më pak;
- g) rënie nga një lartësi;
- h) goditja elektrike dhe puna me linjat e tensionit;
- i) mbytja;
- j) prerjet nga sharra elektrike që mbahet në dorë;
- k) pajisje me presion të lartë;
- l) plagë plumbi ose thike;
- m) zhurma e dëmshme.

KËRKESA THELBËSORE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN

VËREJTJE PARAPRAKE

1. Kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin të përcaktuara në këtë Rregullore janë të detyrueshme.
2. Detyrimet, në lidhje me kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, zbatohen vetëm kur ekziston rreziku përkatës për PMP-të në fjalë.
3. Kërkesat thelbësore për sigurinë dhe shëndetin duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh situatën dhe praktikën aktuale në momentin e projektimit dhe prodhimit, si dhe konsideratat teknike dhe ekonomike, që janë në përputhje me një shkallë e lartë

të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë.

4. Prodhuesi duhet të kryejë një vlerësim të riskut, që të identifikojë risqet që vlejné për PMP-në e tij. Ai më pas do ta projektojë dhe prodhojë atë duke marrë parasysh vlerësimin.

5. Prodhuesi, kur projekton dhe prodhon PMP-në, dhe kur harton udhëzimet, duhet të parashikojë jo vetëm përdorimin e synuar të PMP-së, por edhe përdorimet e parashikueshme në mënyrë të arsyeshme. Kur është e mundur, duhet të garantohet shëndeti dhe siguria e të tjerëve përveç përdoruesit.

1. KËRKESA TË PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR TË GJITHA PMP-të

PMP-të duhet të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme nga risqet ndaj të cilave synojné të mbrojnë.

1.1 Parimet e projektimit

1.1.1 Ergonomia

PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që, në kushtet e parashikueshme të përdorimit të synuar, përdoruesi të mund të kryejë aktivitetin e lidhur me riskun në mënyrë normale ndërsa gëzon mbrojtjen e duhur të nivelit më të lartë të mundshëm.

1.1.2 Nivelet dhe klasat e mbrojtjes

1.1.2.1 Niveli optimal i mbrojtjes

Niveli optimal i mbrojtjes, që duhet të merret parasysh në projektim, është ai nivel përtej të cilit kufizimet e vendosura nga veshja e PMP-ve do të parandalonin përdorimin efektiv të tyre gjatë periudhës së ekspozimit ndaj riskut ose kryerjen normale të aktivitetit.

1.1.2.2 Klasat e mbrojtjes së përshtatshme për nivele të ndryshme të riskut

Aty ku kushtet e ndryshme të parashikueshme të përdorimit janë të tilla që mund të dallohen disa nivele të të njëjtit risk, klasat e përshtatshme të mbrojtjes duhet të merren parasysh në projektimin e PMP-ve.

1.2 PMP të padëmshme

1.2.1 Mungesa e risqeve të qenësishme dhe faktorëve të tjerë shqetësues

PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që të mos krijojnë risqe ose faktorë të tjerë shqetësues në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

1.2.1.1 Materiale përbërëse të përshtatshme

Materialet me të cilat bëhen PMP-të, sidomos ndonjë nga produktet e tyre të mundshme të dekompozimit, nuk duhet të ndikojné negativisht në shëndetin ose sigurinë e përdoruesve.

1.2.1.2 Gjendje e kënaqshme sipërfaqësore e të gjitha pjesëve të PMP-ve në kontakt me përdoruesin

Çdo pjesë e PMP-ve që është në kontakt ose mund të bjerë në kontakt me përdoruesin kur vendoset PMP-ja, duhet të mos ketë sipërfaqe të ashpra, buzë të mprehta, pika të mprehta dhe të ngjashme që mund të shkaktojnë acarim ose dëmtim të tepruar.

1.2.1.3 Pengesa maksimale e lejuar ndaj përdoruesit

Çdo pengesë e shkaktuar nga PMP-të ndaj veprimeve që do të kryhen, qëndrimit që do të mbahet dhe perceptimeve shqisore duhet të minimizohet. Gjithashtu, përdorimi i PMP-ve nuk duhet të shkaktojë veprime të cilat mund të rrezikojné përdoruesin.

1.3 Komforti dhe efektiviteti

1.3.1 Përshtatja e PMP-ve me morfologjinë e përdoruesit

PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet pozicionimi korrekt i tyre te përdoruesi dhe të përdoren për periudhën e parashikueshme të përdorimit, duke mbajtur parasysh faktorët e ambientit, veprimet që do të kryhen dhe qëndrimet që do të mbahen. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur që PMP-të të përshtaten me morfologjinë e përdoruesit me të gjitha mjetet e duhura, siç janë sistemet e duhura të rregullimit dhe të lidhjes ose ofrimi i një game të mjaftueshme madhësish.

1.3.2 Lehtësia dhe fuqia

PMP-të duhet të jenë sa më të lehta që të jetë e mundur, pa ndikuar te fuqia dhe efektiviteti i tyre.

PMP-të duhet të plotësojnë kërkesat specifike shtesë, në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme ndaj risqeve për të cilat janë menduar; dhe PMP-të duhet t'i rezistojné faktorëve

mjedisorë në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

1.3.3 Përputhshmëria e llojeve të ndryshme të PMP-ve të destinuara për përdorim të njëkohshëm

Nëse i njëjti prodhues vendos në treg disa modele PMP-je, të llojeve të ndryshme, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e njëkohshme e pjesëve të afërta trupit, ato duhet të jenë të përputhshme.

1.3.4 Veshje mbrojtëse me pjesë mbrojtëse që hiqen

Veshjet mbrojtëse që përmbajnë pjesë mbrojtëse që hiqen përbëjnë PMP-të dhe do të vlerësohen si një kombinim gjatë procedurave të vlerësimit të konformitetit.

1.4 Udhëzimet dhe informacioni i prodhuesit

Përveç emrit dhe adresës së prodhuesit, udhëzimet që duhet të jepen me PMP-të duhet të përmbajnë të gjitha informacionet përkatëse për:

a) udhëzimet për ruajtjen, përdorimin, pastrimin, mirëmbajtjen, kujdesin dhe dezinfektimin. Pastrimi, mirëmbajtja ose produktet e dezinfektimit, të rekomanduara nga prodhuesit, nuk duhet të kenë efekt negativ të PMP-të ose përdoruesi, kur aplikohen në përputhje me udhëzimet përkatëse;

b) performancën, siç është regjistruar gjatë testeve teknike përkatëse, për të kontrolluar nivelet ose klasat e mbrojtjes të ofruara nga PMP-të;

c) sipas rastit, aksesorët që mund të përdoren me PMP-të dhe karakteristikat e pjesëve rezervë të përshtatshme;

d) sipas rastit, klasat e mbrojtjes së përshtatshme për nivele të ndryshme të riskut dhe kufijtë përkatës të përdorimit;

e) sipas rastit, muajin dhe vitin ose periudhën e vjetërsimit të PMP-ve ose të disa përbërësve të tyre;

f) sipas rastit, llojin e paketimit të përshtatshëm për transport;

g) kuptimin e çdo markimi (shih pikën 2.12);

h) riskun ndaj të cilit PMP-ja është projektuar që të mbrojë;

i) referencën për këtë Rregullore dhe, sipas rastit, referencat për legjislacion tjetër harmonizimi të bashkimit;

j) emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të organit të miratuar ose organeve të përfshira në vlerësimin e konformitetit të PMP-ve;

k) referencat për standard/in(et) përkatës/e të harmonizuar/a të përdorur/a, përfshirë datën e standardit(ve), ose referencat për specifikimet e tjera teknike të përdorura;

l) adresën e internetit ku mund të gjendet deklarata EU e konformitetit.

Informacioni i përmendur në pikat: “i”, “j”, “k” dhe “l” nuk ka nevojë të përfshihet në udhëzimet që jep prodhuesi, nëse PMP-ja shoqërohet me deklaratën EU të konformitetit.

2. KËRKESA SHITESË TË PËRBASHKËTA PËR DISA LLOJE PMP-je

2.1 PMP që përfshin sisteme rregullimi

Nëse PMP-ja përfshin sisteme rregullimi, këto të fundit duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që, pas rregullimit, ato të mos zhbëhen pa dashje në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

2.2 PMP që veshin pjesët e trupit që do të mbrohen

PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që të minimizohet djersitja nga përdorimi. Përndryshe duhet të jenë të pajisura me mjete që thithin djersën.

2.3 PMP për fytyrën, sytë dhe sistemin e frymëmarrjes

Çdo kufizim i fytyrës, syve, fushëpamjes ose sistemit të frymëmarrjes së përdoruesit nga PMP-ja do të minimizohet.

Ekranet për ato lloje PMP-je duhet të kenë një shkallë neutraliteti optik që është në përputhje me shkallën e saktësisë dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve të përdoruesit.

Nëse është e nevojshme, këto PMP duhet të trajtohen ose të pajisen me mjete që parandalojnë veshjen e tyre me avull.

Modelet e PMP-ve, të destinuara për përdoruesit që kërkojnë korigjim të shikimit, duhet të jenë në përputhje me mbajtjen e syzeve ose lenteve të kontaktit.

2.4 PMP që vjetërsohen

Nëse dihet që performanca e projektimit të PMP-ve të reja mund të ndikohet ndjeshëm nga vjetërsimi, muaji dhe viti i prodhimit dhe/ose, nëse është e mundur, muaji dhe viti i vjetërsimit duhet të shënohen në mënyrë të tillë që të mos fshihen dhe të jenë të qartë në secilin artikull të PMP-ve që vendosen në treg dhe në paketimin e tyre.

Nëse prodhuesi nuk është në gjendje të angazhohet në lidhje me jetëgjatësinë e PMP-ve, udhëzimet e tij duhet të japin të gjithë informacionin e nevojshme për të bërë të mundur që blerësi ose përdoruesi të përcaktojnë një muaj dhe vit të arsyeshëm të vjetërsimit, duke marrë parasysh nivelin e cilësisë së modelit dhe kushtet efektive të ruajtjes, përdorimit, pastrimit, kujdesit dhe mirëmbajtjes.

Kur përkeqësimi i dukshëm dhe i shpejtë i performancës së PMP-ve ka të ngjarë të shkaktohet nga vjetërsimi, që rezulton nga përdorimi periodik i një procesi pastrimi të rekomanduar nga prodhuesi, ky i fundit, nëse është e mundur, duhet të vendosë një markim në secilin artikull të PMP-ve të vendosur në treg, që tregon numrin maksimal të veprimeve të pastrimit, që mund të kryhen para se pajisja të ketë nevojë për t'u kontrolluar ose të hidhet. Kur nuk vendoset një markim i tillë, prodhuesi duhet ta japë atë informacion në udhëzimet e tij.

2.5 PMP të cilat mund të kapen gjatë përdorimit

Kur kushtet e parashikueshme të përdorimit përfshijnë, në veçanti, riskun që PMP-të të kapen nga një objekt në lëvizje, duke krijuar kështu një rrezik për përdoruesin, PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që një pjesë përbërëse të thyhet ose të copëtohet, duke shmangur kështu rrezikun.

2.6 PMP për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes

PMP-të e destinuara për përdorim në atmosferë potencialisht shpërthyes duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të mos mund të jenë burim i një harku ose shkëndije elektrike, elektrostatische ose të shkaktuar nga tronditja që mund të shkaktojë ndezjen e një përzierjeje shpërthyes.

2.7 PMP të destinuara për ndërhyrje të shpejtë ose për t'u vendosur ose hequr me shpejtësi

Ato lloj PMP-je duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të minimizojnë kohën e nevojshme për vendosjen dhe heqjen e pajisjeve.

Kur PMP-ja përfshin sisteme fiksime, që bëjnë të mundur që PMP-të të mbahet në pozicionin e saktë të përdoruesi ose të hiqen, duhet të jetë e mundur që këto sisteme të funksionojnë shpejt dhe lehtë.

2.8 PMP për ndërhyrje në situata shumë të rrezikshme

Udhëzimet e dhëna nga prodhuesi për PMP-të për ndërhyrje në situata shumë të rrezikshme duhet të përfshijnë, në veçanti, të dhënat e destinuara për persona kompetentë, të trajnuar, të cilët janë të kualifikuar për t'i interpretuar ato dhe për të siguruar përdorimin e tyre nga përdoruesi.

Gjithashtu udhëzimet duhet të përshkruajnë procedurën që do të miratohet në mënyrë që të verifikohet rregullimi dhe funksionimi i duhur i PMP-ve kur përdoren nga përdoruesi.

Kur PMP-ja përfshin një alarm i cili aktivizohet në mungesë të nivelit të mbrojtjes së parashikuar normalisht, alarmi duhet të projektohet dhe të vendoset në mënyrë që të mund të perceptohet nga përdoruesi në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

2.9 PMP që përfshin elemente që mund të rregullohen ose të hiqen nga përdoruesi

Kur PMP-ja përfshin elemente që mund të bashkëngjiten, rregullohen ose hiqen nga përdoruesi për qëllime zëvendësimi, këto elemente duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që të bashkëngjiten, të rregullohen dhe të hiqen lehtësisht pa vegla.

2.10 PMP për lidhje me pajisje plotësuese të jashtme të PMP-ve

Kur PMP-ja përfshin një sistem konjeksioni, që lejon lidhjen e tij me pajisje të tjera plotësuese, mjetet e lidhjes duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të mundësohet montimi i tyre vetëm në pajisjen e përshtatshme.

2.11 PMP që përfshin një sistem qarkullimi të lëngjeve

Kur PMP-ja përfshin një sistem qarkullimi të lëngjeve, ky i fundit duhet të zgjidhet ose të

projektohet dhe të vendoset në mënyrë të tillë që të lejojë ripërtëritjen e duhur të lëngut në afërsi të të gjithë pjesës së trupit që do të mbrohet, pavarësisht nga veprimet, qëndrimet ose lëvizjet e përdoruesit në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

2.12 PMP që ka një ose më shumë markime identifikimi ose tregues që lidhen drejtpërdrejt ose jo me shëndetin dhe sigurinë

Kur PMP-ja ka një ose më shumë markime identifikimi ose tregues, që lidhen drejtpërdrejt ose jo me shëndetin dhe sigurinë, këto markime identifikimi ose tregues, nëse është e mundur, duhet të jenë në formën e piktogrameve ose ideogrameve të harmonizuara. Ato duhet të jenë të dukshme dhe të lexueshme në mënyrë të përsosur dhe të qëndrojnë të pandryshueshme gjatë gjithë jetëgjatësisë së parashikueshme të PMP-ve. Gjithashtu, ato markime duhet të jenë të plota, precize dhe të kuptueshme në mënyrë që të parandalohet çdo keqinterpretim. Në veçanti, kur këto markime përfshijnë fjalë ose fjali, këto të fundit duhet të shkruhen në një gjuhë të kuptueshme lehtësisht nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë fundorë, siç përcaktohet nga ky rregull teknik, kur PMP-ja bëhet e disponueshme në treg.

Kur PMP-ja është shumë e vogël për të mundur fiksimin e të gjithë ose një pjese të markimit të nevojshëm, informacioni përkatës duhet të jepet në paketim dhe në udhëzimet e prodhuesit.

2.13 PMP që mund të sinjalizojë praninë e përdoruesit në mënyrë vizuale

PMP-ja e destinuar për kushtet e parashikueshme të përdorimit, ku prania e përdoruesit duhet të sinjalizohet dukshëm dhe individualisht, duhet të ketë një (ose më shumë) mjet/e ose pajisje të vendosura me kujdes për të emetuar rrezatim të dukshëm, të drejtpërdrejtë ose të reflektuar, të intensitetit të duhur të dritës dhe veçorive fotometrike dhe kolorimetrike.

2.14 PMP për shumësi risqesh

PMP-të e destinuar për të mbrojtur përdoruesin nga disa rreziqe të mundshme të njëkohshme duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të plotësojnë, në veçanti, kërkesat thelbësore për shëndetin dhe sigurinë specifike për secilin prej atyre risqeve.

3. KËRKESA SHITESË SPECIFIKE PËR RISQE TË VEÇANTA

3.1 Mbrojtja nga tronditja mekanike

3.1.1 Tronditja e shkaktuar nga objekte në rënie ose hedhje dhe përplasja e pjesëve të trupit me një pengesë

PMP-ja e destinuar për të mbrojtur nga ky lloj risku duhet të jenë mjaftueshëm amortizuese për të parandaluar dëmtimin që rezulton, në veçanti, nga thërrmimi ose depërtimi i pjesës së mbrojtur, të paktën deri në një nivel energjie të tronditjes mbi të cilin dimensionet e tepërta ose masa e mjeteve të amortizimit të tronditjeve do të pengonte përdorimin efektiv të PMP-s për periudhën e parashikueshme të përdorimit.

3.1.2 Rëniet

3.1.2.1 Parandalimi i rënies për shkak të rrëshqitjes

Shtresat e jashtme të këpucëve të destinuar për të parandaluar rrëshqitjen duhet të projektohen dhe të prodhohen ose pajisen me mjete shtesë, në mënyrë që të sigurohet mbërthimi i duhur, duke pasur parasysh natyrën ose gjendjen e sipërfaqes.

3.1.2.2 Parandalimi i rënies nga një lartësi

PMP-të e destinuar për të parandaluar rënien nga një lartësi ose efektet e saj duhet të përfshijnë rripa sigurimi për trupin dhe sistemin e lidhjes që mund të kapet me një pikë të jashtme të qëndrueshme ankorimi. Duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që, në kushtet e parashikueshme të përdorimit, rënia vertikale e përdoruesit të minimizohet për të parandaluar përplasjen me pengesat ndërkohë që forca e frenimit të mos arrijë vlerën e pragut ku të pritët të ndodhë dëmtimi fizik ose hapja apo thyerja e ndonjë elementi të PMP-s që mund shkaktojë rrëzimin e përdoruesit.

Këto PMP duhet gjithashtu të sigurojnë që, pas frenimit, përdoruesi të qëndrojë në një pozicion ku mund të presë ndihmë nëse është e nevojshme.

Udhëzimet e prodhuesit duhet të specifikojnë, në veçanti, të gjitha informacionet përkatëse, në lidhje me:

- a) karakteristikat e kërkuara për pikën e jashtme të qëndrueshme të ankorimit dhe hapësirën

minimale të nevojshme nën përdoruesin;

b) mënyrën e duhur për të veshur rripat e sigurimit të trupit dhe për të kapur sistemin e lidhjes me pikën e jashtme të qëndrueshme të ankorimit.

3.1.3 Dridhje mekanike

PMP-të e krijuara për të parandaluar efektet e dridhjeve mekanike duhet të kenë mundësi të sigurojnë zbutjen e duhur të elementeve të dëmshme të dridhjeve për pjesën e trupit në rrezik.

3.2 Mbrojtja ndaj shtypjes statike të një pjese të trupit

PMP-të e krijuara për të mbrojtur një pjesë të trupit nga forca shtypëse statike duhet të jenë mjaft në gjendje të zbusin efektet e saj, në mënyrë që të parandalojnë dëmtime të rënda ose ankesa kronike.

3.3 Mbrojtja nga dëmtimet mekanike

Materialet përbërëse të PMP-ve dhe elementet e tjera të krijuara për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga dëmtimet sipërfaqësore, të tilla si: gërryerja, vrimat, prerjet ose kafshimet, duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të inkorporohen në mënyrë që të sigurojnë që ato lloje PMP-je të ofrojnë rezistencë të mjaftueshme ndaj gërryerjes, vrimave dhe çarjes (shih gjithashtu pikën 3.1, sipas kushteve të parashikueshme të përdorimit).

3.4 Mbrojtja në mjedise të lëngshme

3.4.1 Parandalimi i mbytjes

PMP-të e projektuara për të parandaluar mbytjen duhet të kenë aftësinë për t'u kthyer sa më shpejt të jetë e mundur në sipërfaqe, pa rrezikuar shëndetin; përdoruesin i cili mund të jetë i rraskapitur ose i pavetëdijshëm pas rënies në një mjedis të lëngshëm dhe të mbajë përdoruesin në sipërfaqe në një pozicion që lejon frymëmarrjen ndërsa pret ndihmë.

PMP-të mund të jetë plotësisht ose pjesërisht lundruese ose mund të fryhen me gaz, i cili mund të lirohet manualisht ose automatikisht, ose të fryhet me gojë.

Në kushtet e parashikueshme të përdorimit:

a) PMP-të, pa cenuar funksionimin e tyre të kënaqshëm, duhet të jenë në gjendje të përballojnë efektet e ndikimit në mjedisin e lëngshëm dhe faktorët e mjedisit të natyrshëm në atë mjedis;

b) PMP-të me fryrje duhet të jenë të tilla që të fryhen shpejt dhe plotësisht.

Aty ku e kërkojnë kushte të veçanta të parashikueshme të përdorimit, lloje të caktuara të PMP-ve, gjithashtu, duhet të plotësojnë një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme shtesë:

a) ato duhet të kenë të gjitha pajisjet për fryrje të përmendura në nënparagrafin e dytë, dhe/ose një pajisje sinjalizimi me dritë ose tingull;

b) ato duhet të kenë një pajisje për të ngritur dhe kapur trupin, në mënyrë që përdoruesi të mund të ngrihet mbi mjedisin e lëngshëm;

c) ato duhet të jenë të përshtatshme për përdorim të zgjatur gjatë gjithë periudhës së aktivitetit ku përdoruesi, ndoshta i veshur, ekspozohet ndaj riskut të rënies në mjedisin e lëngët ose që kërkon zhytjen e përdoruesit në atë mjedis.

3.4.2 Ndihmesa për lundrim

Veshjet që synojnë të sigurojnë një shkallë efektive lundrimi, varësisht nga përdorimi i tyre i parashikueshëm, duhet të jenë të sigurta kur të vishen dhe të ofrojnë mbështetje pozitive në mjedisin e lëngshëm. Në kushtet e parashikueshme të përdorimit, PMP-të nuk duhet të kufizojnë lirinë e lëvizjes së përdoruesit, por duhet të bëjnë të mundur, në veçanti, që përdoruesi të notojë ose të marrë masa për të shpëtuar nga rreziku ose për të shpëtuar persona të tjerë.

3.5 Mbrojtja nga efektet e dëmshme të zhurmës

PMP-të e destinuar për të parandaluar efektet e dëmshme të zhurmës duhet të jenë në gjendje të zbusin këtë të fundit, në mënyrë që ekspozimi i përdoruesit të mos kalojë vlerat kufi të përcaktuara, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi që rregullon kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë, në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizikë (zhurma)..

Secili artikull i PMP-ve duhet të ketë etiketë që tregon nivelin e zbutjes së zhurmës, që ofron PMP-ja. Nëse kjo nuk është e mundur, etiketa duhet të ngjitet në paketim.

3.6 Mbrojtja nga nxehtësia dhe/ose zjarri

PMP-të e krijuara për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga efektet e nxehtësisë dhe/ose zjarrit duhet të kenë kapacitet izolues termik dhe forcë mekanike të përshtatshme, për kushtet e parashikueshme të përdorimit.

3.6.1 Materialet përbërëse të PMP-ve dhe elementet e tjera

Materialet përbërëse dhe elementet e tjera të destinuara për mbrojtje nga nxehtësia rrezatuese dhe konvektive duhet të kenë një koeficient të përshtatshëm të transmetimit të fluksit të nxehtësisë incidentale dhe të jenë mjaft të durueshme ndaj ndezjes, për të përjashtuar çdo rrezik të ndezjes spontane në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Kur sipërfaqja e jashtme e atyre materialeve dhe e elementeve duhet të jetë pasqyruese, fuqia e pasqyrimit duhet të jetë e përshtatshme me intensitetin e fluksit të nxehtësisë për shkak të rrezatimit në intervalin infra të kuq.

Materialet dhe elementet e tjera të pajisjeve të destinuara për përdorim të shkurtër në ambiente me temperaturë të lartë dhe të PMP-ve të cilat mund të spërkaten nga produkte të nxehta, siç është materiali i shkrirë, gjithashtu, duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm termik për të mbajtur pjesën më të madhe të nxehtësisë së depozituar derisa përdoruesi të jetë larguar nga zona e rrezikut dhe të ketë hequr PMP-n.

Materialet e PMP-ve dhe elementet e tjerë që mund të spërkaten nga produktet e nxehta duhet gjithashtu të thithin mjaftueshëm tronditjet mekanike (shih pikën 3.1).

Materialet e PMP-ve dhe elementet e tjerë që aksidentalisht mund të bien në kontakt me flakën dhe ato që përdoren në prodhimin e pajisjeve industriale ose zjarrfikëse duhet gjithashtu të kenë një shkallë të mosndezshmërisë dhe mbrojtjes nga nxehtësia termike ose harkore, që korrespondon me klasën e riskut të lidhur me kushtet e parashikueshme të përdorimit. Ato nuk duhet të shkrijnë kur ekspozohen ndaj flakës dhe as të shkaktojnë përhapjen e flakës.

3.6.2 PMP të plotësuara, gati për përdorim

Në kushtet e parashikueshme të përdorimit:

a) sasia e nxehtësisë së përcjellë nga PMP-ja te përdoruesi duhet të jetë mjaft e ulët, për të parandaluar që nxehtësia e grumbulluar gjatë konsumimit në një pjesë të trupit në risk të mos arrijë, në asnjë rrethanë, në kufirin e dhimbjes ose dëmtimit ndaj shëndetit;

b) PMP-ja, nëse është e nevojshme, duhet të parandalojë depërtimin e lëngut ose avullit dhe nuk duhet të shkaktojë djegie që rezultojnë nga kontakti ndërmjet elementit mbrojtës të tij dhe përdoruesit.

Nëse PMP-ja përfshin pajisje ftohëse për thithjen e nxehtësisë, incidente me anë të avullimit të një lëngu ose sublimimit të një trupi të ngurtë, projektimi i këtyre pajisjeve duhet të jetë i tillë që çdo substancë e paqëndrueshme e çliruar të shkarkohet përtej veshjes mbrojtëse të jashtme dhe jo drejt përdoruesit.

Nëse PMP-ja përfshin një pajisje për frymëmarrjen, ajo pajisje duhet të përmbushë në mënyrë të duhur funksionin mbrojtës që i është caktuar në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Udhëzimet e prodhuesit që shoqërojnë PMP-të e destinuara për përdorim të shkurtër në ambiente me temperaturë të lartë, në veçanti, duhet të japin të gjitha të dhënat përkatëse për përcaktimin e ekspozimit maksimal të lejuar të përdoruesit ndaj nxehtësisë së transmetuar nga pajisja, kur përdoret në përputhje me qëllimin e saj të synuar.

3.7 Mbrojtja ndaj të ftohtit

PMP-të e krijuara për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga efektet e të ftohtit duhet të kenë kapacitet izolues termik dhe forcë mekanike të përshtatshme për kushtet e parashikueshme të përdorimit për të cilat janë destinuar.

3.7.1 Materialet përbërëse të PMP-ve dhe elementet e tjera

Materialet përbërëse dhe elementet e tjera të përshtatshme për mbrojtjen nga i ftohti duhet të kenë një koeficient transmetimi të fluksit termik incidenti aq të ulët sa kërkohet në kushtet e parashikueshme të përdorimit. Materialet fleksibël dhe elementet e tjera të PMP-ve të destinuara për përdorim në një mjedis me temperaturë të ulët duhet të ruajnë shkallën e fleksibilitetit të kërkuar për gjestet dhe qëndrimet e nevojshme.

Materialet e PMP-ve dhe elementet e tjera që mund të spërkaten nga produktet e ftohta duhet

gjithashtu të thithin mjaftueshëm tronditjet mekanike (shih pikën 3.1).

3.7.2 PMP të plotësuara, gati për përdorim

Në kushtet e parashikueshme të përdorimit, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) fluksi i transmetuar nga PMP-të të përdoruesi duhet të jetë mjaft i ulët për të parandaluar që i ftohti gjatë veshjes, në çdo pikë, në pjesën e trupit që mbrohet, sidomos majat e gishtërinjve dhe këmbëve në rastin e duarve ose këmbëve, të mos arrijë, në asnjë rrethanë, në kufirin e dhimbjes ose dëmtimit të shëndetit;

b) sa më shumë të jetë e mundur, PMP-të duhet të parandalojnë depërtimin e lëngjeve të tilla si uji i shiut dhe nuk duhet të shkaktojnë dëmtime që rezultojnë nga kontakti mes veshjes mbrojtëse ndaj të ftohtit dhe përdoruesit.

Nëse PMP-ja përfshin një pajisje për frymëmarrjen, ajo pajisje duhet të përmbushë në mënyrë të duhur funksionin mbrojtës që i është caktuar në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Udhëzimet e prodhuesit që shoqërojnë PMP-të e destinuara për përdorim të shkurtër në ambiente me temperaturë të ulët duhet të japin të gjitha të dhënat përkatëse për përcaktimin e ekspozimit maksimal të lejuar të përdoruesit ndaj të ftohtit së përcjellë nga pajisja.

3.8 Mbrojtja nga goditja elektrike

3.8.1 Pajisjet izoluese

PMP-të e projektuara për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga efektet e rrymës elektrike duhet të jenë të izoluara mjaftueshëm nga tensionet ndaj të cilave përdoruesi mund të ekspozohet në kushtet më të pafavorshme të parashikueshme.

Për këtë qëllim, materialet përbërëse dhe elementet e tjera të atyre PMP-ve duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të inkorporohen në mënyrë që të sigurohet që rryma e rrjedhjes, e matur përmes veshjes mbrojtëse, në kushtet e testimit në voltazh të ndërlydhur me atë që mund të haset *in situ* të minimizohet dhe, në çdo rast, të jetë nën një vlerë maksimale të lejueshme konvencionale që lidhet me pragun e tolerancës.

Së bashku me paketimin e tyre, llojet e PMP-ve të destinuara ekskluzivisht për përdorim gjatë punës ose aktiviteteve, në instalimet elektrike të cilat janë ose mund të jenë nën tension, duhet të mbajnë markimet që tregojnë, në veçanti, klasën e tyre të mbrojtjes ose voltazhin përkatës të funksionimit, numrin e tyre të serisë dhe datën e tyre të prodhimit. Duhet të sigurohet gjithashtu një hapësirë jashtë veshjes mbrojtëse të PMP-ve për mbishkrimin e radhës të datës së hyrjes në funksionim dhe të testeve periodike ose inspektimeve që do të kryhen.

Udhëzimet e prodhuesit duhet të tregojnë, në veçanti, përdorimin ekskluziv për të cilin janë destinuar ato lloj PMP-je dhe natyrën dhe shpeshtinë e testeve dielektrike, të cilave do t'u nënshtrohen gjatë jetëgjatësisë së tyre.

3.8.2 Pajisjet përçuese

PMP-të përçuese, të destinuara për punën me tensionin e lartë, duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë që nuk ka ndryshim të potencialit mes përdoruesit dhe instalimeve ku ai do të ndërhyjë.

3.9 Mbrojtja nga rrezatimi

3.9.1 Rrezatimi jojonizues

PMP-të e krijuara për të parandaluar dëmtimin akut ose kronik të syve, nga burimet e rrezatimit jojonizues, duhet të jetë në gjendje të thithin ose të pasqyrojnë shumicën e energjisë së rrezatuar në gjatësinë e valës së dëmshme, pa ndikuar në mënyrë të gabuar në transmetimin e pjesës së padëmshme të spektrit të dukshëm, perceptimin e kontrasteve dhe aftësinë për të dalluar ngjyrat, kur e kërkojnë kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Për këtë qëllim, pajisjet mbrojtëse të syve duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që të kenë, për secilën gjatësi vale të dëmshme, një faktor transmetues spektral, të tillë që dendësia e ndriçimit të energjisë rrezatuese që arrin në syrin e përdoruesit përmes filtrit të minimizohet dhe në asnjë rrethanë të mos kalojë vlera maksimale të lejuar të ekspozimit. PMP-të e projektuara për të mbrojtur lëkurën nga rrezatimi jojonizues duhet të jenë në gjendje të thithin ose pasqyrojnë shumicën e energjisë së rrezatuar në gjatësinë e valës së dëmshme.

Gjithashtu, syzet nuk duhet të përkeqësojnë ose të humbin vetitë e tyre si rezultat i efekteve të

rrezatimit të emetuar në kushtet e parashikueshme të përdorimit dhe të gjithë mostrat e tregtuara duhet të mbajnë numrin e faktorit mbrojtës që korrespondon me kurbën e shpërndarjes spektrore të faktorit të tyre të transmetimit.

Syzet e përshtatshme për burime rrezatimi të të njëjtit lloj duhet të klasifikohen në rendin rritës të faktorëve të tyre mbrojtës dhe udhëzimet e prodhuesit duhet të tregojnë, në veçanti, mënyrën e zgjedhjes së PMP-së së duhur, duke marrë parasysh kushtet përkatëse të përdorimit, siç është distanca nga burimi dhe shpërndarja spektrore e energjisë së rrezatuar në atë distancë.

Numri përkatës i faktorit mbrojtës duhet të jetë i shënuar në të gjitha mostrat e pajisjeve mbrojtëse të syve nga prodhuesi.

3.9.2 Rrezatimi jonizues

3.9.2.1 Mbrojtja ndaj ndotjes radioaktive të jashtme

Materialet përbërëse të PMP-ve dhe elementet e tjera të krijuara për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga pluhuri radioaktiv, gazrat, lëngjet ose përzierjet e tyre duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të inkorporohen, në mënyrë që të sigurojnë që kjo pajisje të parandalojë në mënyrë efektive depërtimin e ndotësve në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Në varësi të natyrës ose kushteve të këtyre ndotësve, hermetizimi i nevojshëm mund të sigurohet nga papërshkueshmëria e veshjes mbrojtëse dhe/ose nga ndonjë mjet tjetër i përshtatshëm, si sistemet e ventilimit dhe presionit të krijuar për të parandaluar shpërndarjen e kundërt të këtyre ndotësve.

Çdo masë dezaktivizimi, të cilës i nënshtrohet PMP-të, nuk duhet të cenojë ripërdorimin e saj të mundshëm gjatë jetëgjatësisë së parashikueshme të atyre lloj pajisjeve.

3.9.2.2 Mbrojtja nga rrezatimi i jashtëm

PMP-ja e destinuar të ofrojë mbrojtje të plotë të përdoruesit nga rrezatimi i jashtëm ose, në pamundësi të kësaj, zbutjen e duhur të tij, duhet të projektohet për të goditur vetëm rrezatimin nga elektroni i dobët (p.sh. beta) ose fotoni i dobët (p.sh. X, gama).

Materialet përbërëse dhe elementet e tjera të këtyre llojeve të PMP-ve duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të përfshihen, në mënyrë që të sigurojnë shkallën e mbrojtjes së përdoruesit, që nevojitet nga kushtet e parashikueshme të përdorimit, pa çuar në një rritje të kohës së ekspozimit si rezultat i rezistencës së gjeve, qëndrimit ose lëvizjes së përdoruesit (shih pikën 1.3.2).

PMP-ja duhet të ketë një shenjë që tregon llojin dhe trashësinë ekuivalente të materialit përbërës, të përshtatshëm për kushtet e parashikueshme të përdorimit.

3.10 Mbrojtja ndaj substancave dhe përzierjeve të rrezikshme për shëndetin dhe kundër agjentëve të dëmshëm biologjikë

3.10.1 Mbrojtja e frymëmarrjes

PMP-ja e destinuar për mbrojtjen e sistemit të frymëmarrjes duhet të bëjë të mundur furnizimin e përdoruesit me ajër, kur ekspozohet në një atmosferë të ndotur dhe/ose një atmosferë që ka përqendrim të pamjaftueshëm oksigjeni.

Ajri i frymëmarrjes që i furnizohet përdoruesit nga PMP-ja, duhet të sigurohet me mjete të përshtatshme, për shembull pas filtrimit të ajrit të ndotur përmes PMP-së ose nga një burim i jashtëm i pandotur.

Materialet përbërëse dhe elementet e tjera të atyre llojeve të PMP-ve duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të inkorporohen në mënyrë që të sigurojnë frymëmarrjen e duhur të përdoruesit dhe higjienën e frymëmarrjes, për periudhën e konsumimit përkatës, në kushtet e parashikueshme të përdorimit.

Hermetizimi i maskës dhe rënia e presionit në frymëmarrje dhe, në rastin e pajisjeve filtruese, kapaciteti i pastrimit duhet ta mbajnë depërtimin e ndotësve nga atmosfera e ndotur në nivel aq të ulët sa të mos dëmtojnë shëndetin ose higjienën e përdoruesit.

PMP-ja duhet të ketë detaje të karakteristikave specifike të pajisjeve të cilat, së bashku me udhëzimet, mundësojnë që një përdorues i trajnuar dhe i kualifikuar të përdorë PMP-në në mënyrë korrekte.

Në rastin e pajisjeve të filtrimit, udhëzimet e prodhuesit duhet gjithashtu të tregojnë afatin kohor për ruajtjen e filtrave të rinj të mbajtur në paketimin e tyre origjinal.

3.10.2 Mbrojtja nga kontakti me lëkurën dhe me sytë

PMP-ja e destinuar për të parandaluar kontaktin sipërfaqësor të të gjithë ose të një pjese të trupit me substanca dhe përzierje të rrezikshme për shëndetin ose me agjentë të dëmshëm biologjikë, duhet të jetë në gjendje të parandalojë penetrimin ose depërtimin e substancave dhe përzierjeve dhe agjentëve të tillë përmes veshjes mbrojtëse, në kushtet e parashikueshme të përdorimit për të cilat PMP-ja është destinuar.

Për këtë qëllim, materialet përbërëse dhe elementet e tjera të atyre llojeve të PMP-ve duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të inkorporohen në mënyrë që të sigurohet, për aq sa është e mundur, hermetizim i plotë, i cili kur është e nevojshme do të lejojë përdorim të zgjatur ditor ose, në pamundësi të kësaj, hermetizim të kufizuar që kërkon një kufizim të periudhës së konsumimit.

Kur, për shkak të natyrës së tyre dhe kushteve të parashikueshme të përdorimit të tyre, disa substanca dhe përzierje që janë të rrezikshme për shëndetin ose agjentë të dëmshëm biologjikë kanë fuqi të lartë depërtimi, që kufizon kohëzgjatjen e mbrojtjes së ofruar nga PMP-ja në fjalë, kjo e fundit duhet t'i nënshtrohet testeve standarde, me qëllim klasifikimin e tyre në bazë të performancës. PMP-ja, që konsiderohet se është në përputhje me specifikimet e testimit, duhet të ketë një markim që tregon, në veçanti, emrat ose, në mungesë të emrave, kodet e substancave të përdorura në testime dhe periudhën përkatëse standarde të mbrojtjes. Udhëzimet e prodhuesit duhet gjithashtu të përmbajnë, në veçanti, një shpjegim të kodeve (nëse është e nevojshme), një përshkrim të hollësishëm të testeve standarde dhe të gjithë informacionin e duhur për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të përdorimit nën kushtet e ndryshme të parashikueshme të përdorimit.

3.11 Pajisjet e zhytjes

Pajisjet për frymëmarrje duhet të bëjnë të mundur furnizimin e përdoruesit me një përzierje të gaztë për frymëmarrje, në kushte të parashikueshme të përdorimit dhe duke marrë parasysh veçanërisht thellësinë maksimale të zhytjes.

Kur e kërkojnë kushtet e parashikueshme të përdorimit, pajisjet e zhytjes duhet të përmbajnë sa vijon:

- a) një kostum që mbron përdoruesin nga i ftohti (shih pikën 3.7) dhe/ose presioni që rezulton nga thellësia e zhytjes (shih pikën 3.2);
- b) një alarm të krijuar për t'i dhënë përdoruesit paralajmërim të shpejtë të një mosfunksionimi të afërt në furnizimin me përzierjen e gaztë të frymëmarrjes (shih pikën 2.8);
- c) një pajisje shpëtimi që i mundëson përdoruesit kthimin në sipërfaqe (shih pikën 3.4.1).

Shtojca III

DOKUMENTACIONI TEKNIK PËR PMP-të

Dokumentacioni teknik specifikon mjetet e përdorura nga prodhuesi për të siguruar konformitetin e PMP-ve me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, të përmendura në nenin 5 dhe të paraqitura në shtojcën II.

Dokumentacioni teknik përmban të paktën elementet e mëposhtme:

- a) një përshkrim të plotë të PMP-së dhe përdorimit të synuar;
- b) një vlerësim të riskut ndaj të cilit PMP-ja është krijuar që të mbrojë;
- c) një listë të kërkesave thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, që janë në zbatueshme për PMP-në;
- d) projektimin dhe vizatimet dhe skicat e prodhimit të PMP-së dhe të përbërësve, nënpjesëve dhe qarqeve;
- e) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato vizatime dhe skica të përmendura në pikën “d”, dhe funksionimin e PMP-së;
- f) referenca të standardeve të harmonizuara, të përmendura në nenin 14, që janë përdorur për projektimin dhe prodhimin e PMP-së. Në rastin e zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni specifikon pjesët që janë zbatuar;
- g) nëse standardet e harmonizuara nuk janë zbatuar ose janë zbatuar vetëm pjesërisht,

përshkrime të specifikimeve të tjera teknike, që janë zbatuar për të përmbushur kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin;

h) rezultatet e llogaritjeve të projektimit, inspektimeve dhe ekzaminimeve të kryera për të verifikuar konformitetin e PMP-së me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin;

i) raporte për testet e kryera, për të verifikuar konformitetin e PMP-së me kërkesat e zbatueshme thelbësore, për sigurinë dhe shëndetin dhe, sipas rrethanave, për të përcaktuar klasën përkatëse të mbrojtjes;

j) një përshkrim të mjeteve që përdor prodhuesi gjatë prodhimit të PMP-së për të siguruar konformitetin e PMP-s së prodhuar me specifikimet e projektimit;

k) një kopje të udhëzimeve dhe informacionit të prodhuesit, të përcaktuar në pikën 1.4, të shtojcës II;

l) për PMP të prodhuara si një njësi të vetme, për t'iu përshtatur një përdoruesi individual, të gjitha udhëzimet e nevojshme për prodhimin e PMP-së sipas modelit bazë të miratuar;

m) për PMP të prodhuara në seri, ku çdo artikull është përshtatur për një përdorues individual, një përshkrim të masave që duhet të merren nga prodhuesi gjatë përshtatjes dhe procesit të prodhimit, që të sigurohet që çdo artikull i PMP-së të jetë në përputhje me llojin e miratuar dhe me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin.

Shtojca IV

KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT (Moduli A)

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura e vlerësimit të konformitetit sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi të plotë që PMP-të në fjalë përmbushin kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi përcakton dokumentacionin teknik të përshkruar në shtojcën III.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e PMP-ve të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 dhe me kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

4. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

4.1 Prodhuesi vendos markimin CE në çdo PMP të veçantë që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

4.2 Prodhuesi harton me shkrim një deklaratë EU konformiteti për çdo model PMP-je dhe e mban atë, së bashku me dokumentacionin teknik, në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së. Deklarata EU e konformitetit identifikon PMP-në për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU të konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikën 4, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

Shtojca V

EKZAMINIMI EU I TIPIT (Moduli B)

1. Ekzaminimi EU i tipit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit, ku një organ i miratuar ekzaminon projektimin teknik të PMP-së dhe verifikon dhe konfirmon që projektimi teknik i PMP-së plotëson kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen për të.

2. Ekzaminimi EU i tipit kryhet me anë të vlerësimit të përshtatshmërisë së projektimit teknik

të PMP-së, përmes shqyrtimit të dokumentacionit teknik plus ekzaminimit të një mostre, përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, të PMP-së së plotë (tipi i prodhimit).

3. Kërkesa për ekzaminimin EU të tipit

Prodhuesi depoziton kërkesën për ekzaminimin EU të tipit pranë një organi të vetëm të miratuar, të zgjedhur prej tij. Kërkesa përmban:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, në rastin kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, edhe emrin dhe adresën e tij;
- b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është depozituar te një organ tjetër i miratuar;
- c) dokumentacionin teknik të përshkruar në shtojcën III;
- d) mostrën (mostrat) e PMP-së, përfaqësuese të prodhimit të parashikuar. Organi i miratuar mund të kërkojë mostra të tjera, nëse është e nevojshme, për të kryer programin e testimit. Për PMP të prodhuara në seri, ku çdo artikull duhet t'i përshtatet një përdoruesi individual, duhet të parashikohen mostra që përfaqësojnë një gamë përdoruesish të ndryshëm dhe për PMP të prodhuara si njësi unike, për të plotësuar nevojat e një përdoruesi individual, duhet të parashikohet një model bazë.

4. Ekzaminimi EU i tipit

Organi i miratuar:

- a) shqyrtton dokumentacionin teknik për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit teknik të PMP-së. Për kryerjen e këtij ekzaminimi, pika “j”, e shtojcës III, nuk është nevoja të merret parasysh;
- b) për PMP të prodhuara në seri, ku çdo artikull i përshtatet një përdoruesi individual, ekzaminohet përshkrimi i masave për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre;
- c) për PMP të prodhuara si një njësi të vetme për t'iu përshtatur një përdoruesi individual, ekzaminohen të gjitha udhëzimet për prodhimin e PMP-së sipas modelit bazë të miratuar, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre;
- d) verifikon që mostra(t) të jetë(në) prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe identifikon elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si edhe elementet që janë projektuar në përputhje me specifikime të tjera teknike;
- e) kryen ose detyron kryerjen e ekzaminimeve dhe testeve të duhura për të kontrolluar nëse ato zbatohen në mënyrën e duhur, atje ku prodhuesi ka zgjedhur të përdorë zgjidhjet për standardet përkatëse të harmonizuara;
- f) kryen ose detyron kryerjen e ekzaminimeve dhe testeve të duhura për të kontrolluar nëse zgjidhjet e ndërmarra nga prodhuesi, sidomos ato në specifikime të tjera teknike të zbatuara, plotësojnë kërkesat thelbësore përkatëse të sigurisë dhe shëndetit, dhe zbatohen në mënyrën e duhur, kur nuk janë zbatuar zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara.

5. Raport vlerësimi

Organi i miratuar harton një raport vlerësimi që regjistron veprimtaritë e ndërmarra, në përputhje me pikën 4, dhe rezultatet e tyre. Organi i miratuar, pa cenuar detyrimet e tij kundrejt autoritetit miratues e nxjerr përmbajtjen e atij raporti, pjesërisht ose plotësisht, vetëm me miratimin e prodhuesit.

6. Certifikata e ekzaminimit EU të tipit

6.1 Kur tipi plotëson kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, organi i miratuar i lëshon prodhuesit një certifikatë të ekzaminimit EU të tipit.

Periodha e vlefshmërisë së një certifikate të sapo lëshuar dhe, sipas rrethanave, e një certifikate të rinovuar nuk do të kalojë pesë vjet.

6.2 Certifikata e ekzaminimit EU të tipit përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe numrin e identifikimit të organit të miratuar;
- b) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, në rastin kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e këtij të fundit;
- c) identifikimin e PMP-së që mbulon certifikata (numri i tipit);
- d) një deklaratë që tipi i PMP-së është në përputhje me kërkesat e zbatueshme thelbësore për

sigurinë dhe shëndetin;

e) nëse standardet e harmonizuara janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, referencat e këtyre standardeve ose pjesëve të tyre;

f) nëse janë zbatuar specifikime të tjera teknike, referencat e tyre;

g) sipas rrethanave, niveli (nivelet e) i performancës ose klasa e mbrojtjes së PMP-së;

h) për PMP të prodhuara si një njësi të vetme për t'iu përshtatur një përdoruesi individual, masën e variacioneve të lejueshme të parametrave përkatëse, sipas modelit bazë të miratuar;

i) datën e lëshimit, datën e skadimit dhe, sipas rrethanave, datën (datat) e rinovimit;

j) çdo kusht që i bashkëngjitet lëshimit të certifikatës;

k) për PMP të kategorisë III, një deklaratë që certifikata do të përdoret vetëm në përputhje me një nga procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përmendur në pikën “c”, të nenit 19.

6.3 Certifikata e ekzaminimit EU të tipit mund të ketë një ose disa anekse të bashkëngjitura.

6.4 Nëse lloji nuk i përmbush kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, organi i miratuar refuzon lëshimin e një certifikate të ekzaminimit EU të tipit dhe informon kërkuuesin, sipas rrethanave, duke dhënë arsye të detajuara për refuzimin.

7. Rishikimi i certifikatës së ekzaminimit EU të tipit

7.1 Organi i miratuar mbahet i informuar për çdo ndryshim, në situatën e njohur përgjithësisht, e cila tregon se tipi i miratuar nuk mund të plotësojë më kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, dhe përcakton nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse ndodh kështu, organi i miratuar njofton përkatësisht prodhuesin.

7.2 Prodhuesi njofton organin e miratuar që ka dokumentacionin teknik, në lidhje me certifikatën e ekzaminimit EU të tipit, për të gjitha ndryshimet në tipin e miratuar dhe të gjitha ndryshimet e dokumentacionit teknik, të cilat mund të ndikojnë te konformiteti i PMP-së me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin ose kushtet për vlefshmërinë e asaj certifikate. Këto modifikime kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtese të certifikata fillestare e ekzaminimit EU të tipit.

7.3 Prodhuesi sigurohet që PMP-ja të vazhdojë të përmbushë kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin nisur nga situata aktuale.

7.4 Prodhuesi i kërkon organit të miratuar që të rishikojë certifikatën e ekzaminimit EU të tipit ose:

a) në rastin e një ndryshimi të tipit të miratuar, të përmendur në pikën 7.2;

b) në rastin e një ndryshimi të situatës aktuale, të përmendur në pikën 7.3;

c) të paktën, përpara datës së skadimit të certifikatës.

Për të lejuar organin e miratuar që të përmbushë detyrat e tij, prodhuesi e dorëzon kërkesën e tij jo më vonë se 12 muaj dhe jo më përpara se 6 muaj nga data e skadimit të certifikatës EU të ekzaminimit të tipit.

7.5 Organi i miratuar ekzaminon tipin e PMP-së dhe, sipas nevojës, nisur nga ndryshimet e kryera, bën testet përkatëse që të sigurohet se tipi i miratuar vazhdon të përmbushë kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin. Nëse organi i miratuar është i bindur që tipi i miratuar vazhdon të plotësojë kërkesat e zbatueshme për sigurinë dhe shëndetin, ai e rinovon certifikatën e ekzaminimit EU të tipit. Organi i miratuar sigurohet që procedura e rishikimit të finalizohet përpara datës së skadimit të certifikatës së ekzaminimit EU të tipit.

7.6 Nëse nuk plotësohen kushtet e përmendura në pikat “a” dhe “b”, të pikës 7.4, zbatohet një procedurë e thjeshtuar rishikimi. Prodhuesi i jep organit të miratuar, si më poshtë:

a) emrin dhe adresën e tij dhe të dhëna që identifikojnë certifikatën në fjalë të ekzaminimit EU të tipit;

b) konfirmim që nuk ka pasur modifikim të tipit të miratuar, të përmendur në pikën 7.2, sidomos materiale, nënkomponentë ose nënelemente, as të standardeve përkatëse të miratuara apo specifikimeve të tjera teknike të zbatuara;

c) konfirmim që nuk ka pasur ndryshim në situatën aktuale, të përmendur në pikën 7.3;

d) kur nuk janë dhënë tashmë, kopje të vizatimeve dhe fotografive të produktit aktual, markim të produktit dhe informacion që jepet nga prodhuesit; dhe

e) për produktet e kategorisë III, kur nuk janë në dispozicion të organit të miratuar, informacion për rezultatet e kontrolleve të mbikëqyrura të produktit në intervale rastësore, të kryera në përputhje me shtojcën VII, ose për rezultatet e kontrolleve të sistemit të tij të cilësisë, të kryer në përputhje me shtojcën VIII.

Kur organi i miratuar ka konfirmuar që nuk ka ndodhur asnjë ndryshim i tipit të miratuar, të përmendur në pikën 7.2, dhe ndryshim në situatën aktuale, të përmendur në pikën 7.3, zbatohet procedura e thjeshtuar e rishikimit dhe nuk kryhen ekzaminimet dhe testet e përmendura në pikën 7.5. Në këto raste, organi i miratuar rishikon certifikatën e ekzaminimit EU të tipit.

Kostot, në lidhje me atë rishikim, janë proporcionale me barrën administrative të procedurës së thjeshtuar.

Nëse organi i miratuar konstaton që ka ndodhur një ndryshim në situatën aktuale, të përmendur në pikën 7.3, do të zbatohet procedura e përcaktuar në pikën 7.5.

7.7 Nëse, pas rishikimit, organi i miratuar arrin në përfundimin që certifikata e ekzaminimit EU të tipit nuk është më e vlefshme, organi e anulon dhe prodhuesi ndalon vendosjen në treg të PMP-së në fjalë.

8. Çdo organ i miratuar njofton autoritetin miratues, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit EU të tipit, dhe/ose shtesa të tyre, të cilat i ka lëshuar ose i ka tërhequr dhe, rregullisht ose me kërkesë, vë në dispozicion të autoritetit miratues listën e këtyre certifikatave dhe/ose shtesave të tyre të refuzuara, të pezulluara ose përndryshe të kufizuara.

Çdo organ i miratuar njofton organet e tjera të miratuara, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit EU të tipit dhe/ose çdo shtesë që ka refuzuar, tërhequr, pezulluar, ose ndryshe kufizuar dhe, me kërkesë, në lidhje me këto certifikata dhe/ose shtesa të tyre që i ka lëshuar.

Organi i miratuar mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit EU të tipit, shtesave dhe anekseve, si edhe të dosjes teknike që përmban dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në mbarimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

9. Prodhuesi mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit EU të tipit, anekseve dhe shtesave të saj, së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të depozitojë kërkesën, e përmendur në pikën 3, dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 7.2 dhe 9, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

Shtojca VI

KONFORMITETI ME TIPIN BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT (Moduli C)

1. Konformiteti me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit, sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, dhe siguron, dhe deklaron me përgjegjësi të plotë që PMP-të në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e PMP-ve të prodhuara me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe me kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

3. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

3.1 Prodhuesi vendos markimin CE në çdo PMP të veçantë, që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit, dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

3.2 Prodhuesi harton me shkrin një deklaratë EU konformiteti për çdo model PMP-je dhe e mban në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së. Deklarata

EU e konformitetit identifikon PMP-në për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU të konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikën 3, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

Shtojca VII

KONFORMITETI ME TIPIN BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT PLUS KONTROLLE TË MBIKËQYRURA TË PRODUKTTIT NË INTERVALE RASTËSORE (Moduli C2)

1. Konformiteti me tipin, bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus kontrollin e mbikëqyrtur të produktit, në intervale rastësore, është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3, 5.2 dhe 6, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi të plotë që PMP-ja, e cila është objekt i dispozitave të pikës 4, është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë homogjenitetin e prodhimit dhe konformitetin e PMP-ve të prodhuara, tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit, dhe me kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

3. Kërkesa për kontrolle të mbikëqyrura të produktit në intervale rastësore

Përpara se PMP-ja të vendoset në treg, prodhuesi depoziton kërkesë për kontrolle të mbikëqyrura të produktit në intervale rastësore, pranë një organi të vetëm të miratuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përmban sa më poshtë:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, në rastin kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është depozituar te një organ tjetër i miratuar;

c) identifikimin e PMP-së për të cilën bëhet fjalë.

Kur organi i miratuar, i zgjedhur, nuk është organi që ka kryer ekzaminimin EU të tipit, kërkesa do të përmbajë sa më poshtë:

a) dokumentacionin teknik të përshkruar në shtojcën III;

b) një kopje të certifikatës së ekzaminimit EU të tipit.

4. Kontrolle të produktit

4.1 Organi i miratuar kryen kontrolle të produktit, për të verifikuar homogjenitetin e prodhimit dhe konformitetin e PMP-së me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe me kërkesat e zbatueshme thelbësore, për sigurinë dhe shëndetin.

4.2 Kontrolle të produktit kryhen të paktën një herë në vit, në intervale rastësore të përcaktuara nga organi i miratuar. Kontrollat e para të produktit do të kryhen jo më shumë se një vit pas datës së lëshimit të certifikatës së ekzaminimit EU të tipit.

4.3 Një mostër statistikore, e përshtatshme, e PMP-së së prodhuar, përzgjidhet nga organi i miratuar në një vend të dakordësuar ndërmjet organit të miratuar dhe prodhuesit. Të gjithë artikujt e PMP-së së mostrës ekzaminohen dhe kryhen testet e duhura, të përcaktuara në standardin (standartet) përkatëse të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente, të përcaktuara në specifikime të tjera teknike, për të verifikuar konformitetin me tipin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin.

4.4 Nëse organi i miratuar, i përmendur në pikën 3, nuk është organi që ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit EU të tipit, ai do të kontaktojë atë organ në rastin e vështirësive, në lidhje me vlerësimin e konformitetit të mostrës.

4.5 Procedura e pranimit të mostrës, që do të zbatohet, synon të përcaktojë nëse procesi i prodhimit siguron homogjenitetin e prodhimit dhe vepron brenda kufijve të pranueshëm, me qëllim që të sigurohet konformiteti i PMP-së.

4.6 Nëse ekzaminimi dhe testimi tregojnë që prodhimi nuk është homogjen, ose që PMP-ja nuk është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimi EU të tipit ose me kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, organi i miratuar merr masat e duhura për defektin (defektet) e regjistruar dhe informon për to autoritetin miratues.

5. Raport testimi

5.1 Organi i miratuar i jep prodhuesit një raport testimi.

5.2 Prodhuesi mban raportin e testimit në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së.

5.3 Prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, vendos numrin e identifikimit të organit të miratuar gjatë procesit të prodhimit.

6. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

6.1 Prodhuesi vendos markimin CE dhe, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, të përmendur në pikën 3, numrin e identifikimit të këtij të fundit në çdo artikull individual të PMP-së, që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

6.2 Prodhuesi harton me shkrim një deklaratë EU konformiteti për çdo model PMP-je dhe e mban në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së. Deklarata EU e konformitetit identifikon modelin e PMP-së për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU të konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

7. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit. Një përfaqësues i autorizuar nuk mund të përmbushë detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 2.

Shtojca VIII

KONFORMITETI ME TIPIN BAZUAR NË SIGURINË E CILËSISË SË PROCESIT TË PRODHIMIT (Moduli D)

1. Konformiteti me tipin, bazuar në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit, është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit sipas të cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 5 dhe 6, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi ekskluzive që PMP-të në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin e produktit final dhe testimin e PMP-së në fjalë, të specifikuara në pikën 3, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së specifikuar në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi depoziton kërkesën për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë pranë një organi të vetëm të miratuar, të zgjedhur prej tij.

Kërkesa përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, në rastin kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) adresën e ambienteve të prodhuesit ku mund të kryhen kontrole;

- c) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është depozituar te një organ tjetër i miratuar;
- d) identifikimin e PMP-së për të cilën bëhet fjalë;
- e) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë.

Nëse organi i miratuar i zgjedhur nuk është organi që ka kryer ekzaminimin EU të tipit, kërkesa do të përfshijë sa më poshtë:

- a) dokumentacionin teknik të PMP-s së përshkruar në shtojcën III;
- b) një kopje e certifikatës së ekzaminimit EU të tipit.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që PMP-ja të jetë në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit, si edhe me kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi dokumentohen sistematikisht dhe rregullisht në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë lejon interpretimin konsistent të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe të dhënave.

Dokumentacioni për sistemin e cilësisë në veçanti përmban:

- a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit lidhur me cilësinë e produktit;
- b) teknikat përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceset dhe masat sistematike që duhet të përdoren;
- c) ekzaminimet dhe testet që duhet të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, si dhe shpeshtinë e realizimit të tyre;
- d) të dhënat e cilësisë si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testeve dhe kalibrimeve, raporte të kualifikimit për stafin përkatës, etj.;
- e) mjetet e monitorimit të arritjes së cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i miratuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e dhëna në pikën 3.2.

Ai prezumon konformitetin me këto kërkesa, lidhur me elementet e sistemit të cilësisë, që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit ka të paktën një anëtar me përvojë vlerësimi në fushën e PMP-ve dhe teknologjinë përkatëse, dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme për sigurinë dhe shëndetin. Auditimi përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit rishikon dokumentacionin teknik të PMP-së, të përmendur në pikën 3.1(e), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit, për të identifikuar kërkesat e zbatueshme thelbësore për sigurinë dhe shëndetin, dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim sigurimin e konformitetit të PMP-së me këto kërkesa.

Rezultati i atij vlerësimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi merr përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i cilësisë së miratuar dhe mirëmbajtjen e tij me qëllim që të mbetet i duhur dhe efikas.

3.5 Prodhuesi mban të informuar organin e miratuar, që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organi i miratuar vlerëson çdo ndryshim të propozuar dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë do të vazhdojë të plotësojë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 ose nëse nevojitet një rivlerësim.

Ai njofton prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.6 Organi i miratuar autorizon prodhuesin të vendosë numrin e identifikimit të organit të miratuar te çdo artikull i veçantë i PMP-së, që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar

4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurojë që prodhuesi të përmbushë rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi, për qëllime vlerësimi, e lejon organin e miratuar të hyjë te vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit, si edhe i jep atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) të dhënat e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testeve dhe kalibrimeve, raporte të kualifikimit të stafit përkatës.

4.3 Organi i miratuar kryen kontrole të rregullta, të paktën një në vit, për t'u siguruar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep prodhuesit një raport auditimi.

4.4 Gjithashtu, organi i miratuar mund të kryejë vizita të papritura te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë ekzaminime ose teste të PMP-së, ose të detyrojë kryerjen e tyre, për të verifikuar funksionimin korrekt të sistemit të cilësisë. Organi i miratuar i jep prodhuesit një raport mbi vizitën dhe, kur janë kryer testime, një raport të testit.

5. Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

5.1 Prodhuesi vendos markimin CE dhe, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, të përmendur në pikën 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit në çdo artikull individual të PMP-së, që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit EU të tipit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

5.2 Prodhuesi harton me shkrim një deklaratë EU konformiteti për çdo model PMP-je dhe e mban në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së. Deklarata EU e konformitetit identifikon modelin e PMP-së për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU të konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

6. Prodhuesi, për një periudhë 10 vjet pas vënies në treg të PMP-së, vendos në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.1;

b) informacionin në lidhje me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të miratuar të përmendura në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organi i miratuar informon autoritetin miratues për miratimet e sistemit të cilësisë, të lëshuara ose të tërhequra dhe, rregullisht ose me kërkesë, vë në dispozicion të autoritetit miratues listën e miratimeve të sistemit të cilësisë, të refuzuara, të pezulluara ose përndryshe të kufizuara.

Organi i miratuar informon organet e tjera të miratuara për miratimet e sistemeve të cilësisë që ka refuzuar, pezulluar, tërhequr ose përndryshe kufizuar, dhe me kërkesë, për miratime të sistemit të cilësisë që ka dhënë.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, nëse ato janë të specifikuara në aktin e tij të përfaqësimit.

Shtojca IX

DEKLARATA EU E KONFORMITETIT NR²...

1. PMP (numri i produktit, tipit, grupit apo serisë):

2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe, sipas rastit, përfaqësuesit të tij të autorizuar:

3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit:

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i PMP-së që mundëson gjurmueshmëri; kur është e nevojshme për identifikimin e PMP-së, mund të përfshihet një imazh me ngjyra):

5. Objekti i deklaratës, së përshkruar në pikën 4, është në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi:

...

6. Referencat për standardet e harmonizuara të përdorura, përfshirë datën e standardit, ose

² Prodhuesi sipas dëshirës mund t'i vendosë një numër deklaratës së konformitetit.

referencat për specifikime të tjera teknike, përfshirë datën e specifikimit, në lidhje me të cilat deklarohet konformiteti:

7. Sipas rastit, organ i miratuar(emri, numri)....ka kryer ekzaminimin EU të tipit (moduli B) dhe ka lëshuar certifikatën EU të ekzaminimit të tipit... (referencë për atë certifikatë).

8. Sipas rastit, PMP-ja është objekt i procedurës së vlerësimit të konformitetit(ose konformitetit të tipit, bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus kontroll i mbikëqyrur i produktit në intervale rastësore (moduli C2), ose konformitetit të tipit bazuar në sigurinë e cilësisë së procesit të prodhimit (moduli D)... nën mbikëqyrjen e organit të miratuar(emri, numri)).

9. Informacion shtesë:

nënshkruar për dhe në emër të:

... (vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA
Rregullorja (BE) 2016/425, mbi Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP)

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)	Titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1	EN 343:2019 <i>Protective clothing – Protection against</i>	SSH EN 343:2019 Veshje mbrojtëse - Mbrojtja nga shiu.	2019	FP
2	EN 358:2018 <i>Personal protective equipment for work positioning and prevention of falls from a height - Belts and lanyards for work positioning or restraint</i>	SSH EN 358:2018 Pajisje mbrojtëse personale për pozicionim gjate punës dhe për parandalimin e rënies nga lartësia - Rripat dhe litarët e kontrollit për pozicionimin gjate punës.	2019	FP
3	EN 388:2016+A1:2018 <i>Protective gloves against mechanical risks</i>	SSH EN 388:2016+A1:2018 Doreza mbrojtëse ndaj rreziqeve mekanike.	2019	FP
4	EN 510:2019 <i>Specification for protective clothing for use where there is a risk of entanglement with moving parts</i>	SSH EN 510:2019 Specifikimi për veshjet mbrojtëse për përdorim kur ekziston rreziku i prerjes nga pjesët e lëvizshme.	2020	FP
5	EN 893:2019 <i>Mountaineering equipment - Crampons - Safety requirements and test methods</i>	SSH EN 893:2019 Pajisjet për ngjitje në mal - Paftat me thumba - Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës.	2020	FP
6	EN 943-1:2015+A1:2019 <i>Protective clothing against dangerous solid, liquid and gaseous chemicals, including liquid and solid aerosols - Part 1: Performance requirements for Type 1 (gas-tight) chemical protective suits</i>	SSH EN 943-1:2015+A1:2019 Veshje mbrojtëse kundër produkteve të dëmshme kimike të ngurta, të lëngshme dhe të gazta, përfshirë aerosolët e lëngshëm dhe grimcat e ngurta - Pjesa 1: Kërkesa e performancës për veshjet mbrojtëse të ngushta ndaj gazit (të tipit 1) për mbrojtje kimike hermetike.	2019	FP
7	EN 943-2:2019 <i>Protective clothing against dangerous solid, liquid and gaseous chemicals, including liquid and solid aerosols – Part 2: Performance requirements for Type 1 (gas-tight) chemical protective suits for emergency teams (ET)</i>	SSH EN 943-2:2019 Veshje mbrojtëse kundër produkteve të dëmshme kimike të ngurta, të lëngshme dhe të gazta, përfshirë aerosolët e lëngshëm dhe grimcat e ngurta - Pjesa 2: Kërkesat e performancës për veshjet mbrojtëse për mbrojtjen	2019	FP

		kimike hermetike ndaj gazit (tipi 1) të cilat përdoren nga ekipet e emergjencës (ET).		
8	<i>EN 1073-1:2016+A1:2018 Protective clothing against solid airborne particles including radioactive contamination – Part 1: Requirements and test methods for compressed air line ventilated protective clothing, protecting the body and the respiratory tract</i>	SSH EN 1073-1:2016+A1:2018 Veshje mbrojtëse kundër grimcave të përqendruara në ajër duke përfshirë ndotjen radioaktive - Pjesa 1: Kërkesat dhe metoda prove për veshjet mbrojtëse me ajrosje (ventilim) për mbrojtjen e trupit dhe rrugëve të frymëmarrjes.	2019	FP
9	<i>EN ISO 10819:2013 Mechanical vibration and shock - Hand-arm vibration - Measurement and evaluation of the vibration transmissibility of gloves at the palm of the hand (ISO 10819:2013)</i>	SSH EN ISO 10819:2013 Vibracioni dhe goditja mekanike - Vibracioni dorë-krah - Metoda për matjen dhe vlerësimin e transferueshmërisë së vibrimit nëpërmjet dorashkave në shuplakat.	2014	FP
10	<i>EN ISO 10819:2013/A1:2019</i>	SSH EN ISO 10819:2013/A1:2019	2019	FP
11	<i>EN ISO 11393-2:2019 Protective clothing for users of hand-held chainsaws - Part 2: Performance requirements and test methods for leg protectors (ISO 11393-2:2018)</i>	SSH EN ISO 11393-2:2019 Veshje mbrojtëse për përdoruesit e sharrave me zinxhir të cilat mbahen në dorë - Pjesa 2: Kërkesat e performancës dhe metodat e provës për mbrojtëset e këmbës (ISO 11393-2:2018).	2020	FP
12	<i>EN ISO 11393-4:2019 Protective clothing for users of hand-held chainsaws - Part 4: Performance requirements and test methods for protective gloves (ISO 11393-4:2018)</i>	SSH EN ISO 11393-4:2019 Veshje mbrojtëse për përdoruesit e sharrave me zinxhir të cilat mbahen në dorë - Pjesa 4: Kërkesat e performancës dhe metodat e provës për dorezat mbrojtëse (ISO 11393-4:2018).	2020	FP
13	<i>EN ISO 11393-5: 2019 Protective clothing for users of hand-held chainsaws – Part 5: Performance requirements and test methods for protective gaiters (ISO 11393-5:2018)</i>	SSH EN ISO 11393-5:2019 Veshje mbrojtëse për përdoruesit e sharrave me zinxhir të cilat mbahen në dorë - Pjesa 5: Kërkesat e performancës dhe metodat e provës për këpucët me qafa pa lidhëse (ISO 11393-5:2018).	2020	FP
14	<i>EN ISO 11393-6:2019 Protective clothing for users of hand-held chainsaws – Part 6: Performance requirements and test methods for upper body protectors (ISO 11393-6:2018)</i>	SSH EN ISO 11393-6:2019 Veshje mbrojtëse për përdoruesit e sharrave me zinxhir të cilat mbahen në dorë - Pjesa 6: Kërkesat e performancës dhe metodat e provës për mbrojtëset e sipërme të trupit (ISO 11393-6:2018).	2020	FP
15	<i>EN 12277:2015+A1:2018 Mountaineering equipment – Harnesses – Safety requirements and test methods</i>	SSH EN 12277:2015+A1:2018 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Valvulat e bombolave të gazit - Pjesa 1: Bashkues i filetuar për shtagën bashkuese.	2021	FP
16	<i>EN 13832-2:2018 Footwear protecting against chemicals - Part 2: Requirements for limited contact with chemicals</i>	SSH EN 13832-2:2018 Këpucë mbrojtëse kundër produkteve kimike - Pjesa 2: Kërkesat për kontakt të kufizuar me produktet kimike.	2019	FP

17	EN 13832-3:2018 <i>Footwear protecting against chemicals - Part 3: Requirements for prolonged contact with chemicals</i>	SSH EN 13832-3:2018 Këpucë mbrojtëse kundër produkteve kimike - Pjesa 3: Kërkesat për kontakt të zgjatur me produkte kimike.	2019	FP
18	EN 14458:2018 <i>Personal eye-equipment - High performance visors intended only for use with protective helmets</i>	SSH EN 14458:2018 Pajisje personale për mbrojtjen e syrit - Maska për përdorim vetëm me helmata mbrojtëse me performancë të lartë.	2019	FP
19	EN 14594:2018 <i>Respiratory protective devices - Continuous flow compressed air line breathing devices - Requirements, testing and marking</i>	SSH EN 14594:2018 Pajisje mbrojtëse respiratore - Pajisje të frymëmarrjes të ngjeshur me ajër me rrjedhje të vazhdueshme - Kërkesat, testimi dhe shënjimi.	2019	FP
20	EN 50321-1:2018 <i>Live working - Footwear for electrical protection - Insulating footwear and overboots</i>	SSH EN 50321-1:2018 Punime nën tension - Këpucë për mbrojtje elektrike - Këpucë dhe mburoja izoluese.	2018	FP
21	EN 50321-1:2018/AC:2018-08	SSH EN 50321-1:2018/AC:2018	2019	FP
22	EN 1149-5:2018 <i>Protective clothing - Electrostatic properties - Part 5: Material performance and design requirements</i>	SSH EN 1149-5:2018 Veshje mbrojtëse - Vetitë elektrostatische - Pjesa 5: Performanca e materialit dhe kërkesat e projektimit.	2019	FP
23	EN 17092-2:2020 <i>Protective garments for motorcycle riders - Part 2: Class AAA garments - Requirements</i>	SSH EN 17092-2:2020 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët - Pjesa 2: Veshje mbrojtëse të klasit AAA - Kërkesat.	2020	FP
24	EN 17092-3:2020 <i>Protective garments for motorcycle riders - Part 3: Class AA garments - Requirements</i>	SSH EN 17092-3:2020 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët - Pjesa 3: Veshje të klasit AA - Kërkesat.	2020	FP
25	EN 17092-4:2020 <i>Protective garments for motorcycle riders - Part 4: Class A garments - Requirements</i>	SSH EN 17092-4:2020 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët - Pjesa 4: Veshje të klasit A - Kërkesat.	2020	FP
26	EN 17092-5:2020 <i>Protective garments for motorcycle riders - Part 5: Class B garments - Requirements</i>	SSH EN 17092-5:2020 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët - Pjesa 5: Veshje të klasit B - Kërkesat.	2020	FP
27	EN 17092-6:2020 <i>Protective garments for motorcycle riders - Part 6: Class C garments - Requirements</i>	SSH EN 17092-6:2020 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët - Pjesa 6: Veshje të klasit C - Kërkesat.	2020	FP
28	EN 17109:2020 <i>Mountaineering equipment - Individual safety systems for rope courses - Safety requirements and test methods</i>	SSH EN 17109:2020 Pajisjet për ngjitje në mal - Sistemi i sigurisë individuale për litarët e fushave - Kërkesat e sigurisë dhe metodat e testimit.	2020	FP
29	EN 61482-2:2020 <i>Live working - Protective clothing against the thermal hazards of an electric arc - Part 2: Requirements</i>	SSH EN 61482-2:2020 Punime nën tension - Veshje mbrojtëse nga rreziqet termike në një hark elektrik - Pjesa 2: Kërkesat.	2020	FP
30	EN ISO 20320:2020 <i>Protective clothing for use in Snowboarding - Wrist Protectors - Requirements and test methods (ISO 20320:2020)</i>	SSH EN ISO 20320:2020 Veshje mbrojtëse për përdorim në ski në dëborë - Mbrojtëset e kyçeve të këmbës - Kërkesat dhe metodat e provës (ISO 20320:2020).	2020	FP

31	EN 17353:2020 <i>Protective clothing - Enhanced visibility equipment for medium risk situations - Test methods and requirements</i>	SSH EN 17353:2020 Veshje mbrojtëse - Pajisje të përmirësuara të shikimit për situata me rrezik mesatar - Metoda prove dhe kërkesat.	2021	FP
32	EN 469:2020 <i>Protective clothing for firefighters - Performance requirements for protective clothing for firefighting activities</i>	SSH EN 469:2020 Veshje mbrojtëse për zjarrfikësit - Kërkesat e performancës për veshjet mbrojtëse, për aktivitetet e shuarjes së zjarrit.	2021	FP
33	EN ISO 27065:2017 <i>Protective clothing - Performance requirements for protective clothing worn by operators applying pesticides and for re-entry workers (ISO 27065:2017).</i>	SSH EN ISO 27065:2017 Veshje mbrojtëse - Kërkesat e performancës për veshjet mbrojtëse të veshura nga operatorë të cilët përdorin pesticide dhe për punëtorët e rihyrjes (ISO 27065:2017).	2018	FP
34	EN ISO 27065:2017/A1:2019	SSH EN ISO 27065:2017/A1:2019	2020	FP
35	EN 136:1998 <i>Respiratory protective devices - Full face masks - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 136:1998 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Maskat për gjithë fytyrën - Kërkesat, testimi, markimi.	2003	FP
36	EN 136:1998/AC:2003	SSH EN 136:1998/AC:2003	2014	FP
37	EN 137:2006 <i>Respiratory protective devices - Self-contained open-circuit compressed air breathing apparatus with full face mask - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 137:2006 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Autorespiratorë me ajër të ngjeshur, me qark të hapur me maskë të plotë të fytyrës - Kërkesat, testimi, markimi.	2006	FP
38	EN 140:1998 <i>Respiratory protective devices - Half masks and quarter masks - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 140:2000 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Gjysmëmaskat dhe çerek maskat - Kërkesat, provat dhe markimi.	2000	FP
39	EN 140:1998/AC:1999	SSH EN 140:1998/AC:1999	2012	FP
40	EN 142:2002 <i>Respiratory protective devices - Mouthpiece assemblies - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 142:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Bashkuesit e gypave - Kërkesat, testimi, markimi.	2012	FP
41	EN 143:2000 <i>Respiratory protective devices - Particle filters - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 143:2000 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Filtrat kundër pluhurit - Kërkesat, testimi, markimi.	2006	FP
42	EN 143:2000/AC:2005	SSH EN 143:2000/AC:2005	2012	FP
43	EN 143:2000/A1:2006	SSH EN 143:2000/A1:2006	2012	FP
44	EN 144-1:2000 <i>Respiratory protective devices - Gas cylinder valves - Part 1: Thread connections for insert connector</i>	SSH EN 144-1:2001 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Valvulat e bombolave të gazit - Pjesa 1: Bashkues i filetuar për shtagën bashkuese.	2001	FP
45	EN 144-1:2000/A1:2003	SSH EN 144-1:2000/A1:2003	2007	FP
46	EN 144-1:2000/A2:2005	SSH EN 144-1:2000/A2:2005	2007	FP
47	EN 144-2:1998 <i>Respiratory protective devices - Gas cylinder valves - Part 2: Outlet connections</i>	SSH EN 144-2:2000 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Valvulat e bombolave të gazit - Pjesa 2: Bashkimet e daljes.	2000	FP

48	<i>EN 144-3:2003 Respiratory protective devices - Gas cylinder valves - Part 3: Outlet connections for diving gases Nitrox and oxygen</i>	SSH EN 144-3:2003 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Valvulat e bombolave të gazit - Pjesa 3: Rakordet e daljes për gazrat nitrox dhe oksigjen për zhytje.	2006	FP
49	<i>EN 144-3:2003/AC:2003</i>	SSH EN 144-3:2003/AC:2003	2012	FP
50	<i>EN 145:1997 Respiratory protective devices - Self-contained closed-circuit breathing apparatus compressed oxygen or compressed oxygen-nitrogen type - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 145:2000 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Aparate respirimi me vetëpërbajtje, me qark të mbyllur me oksigjen të ngjeshur ose me oksigjen dhe azot të ngjeshur - Kërkesat, testimi, markimi.	2000	FP
51	<i>EN 145:1997/A1:2000</i>	SSH EN 145:1997/A1:2000	2006	FP
52	<i>EN 148-1:1999 Respiratory protective devices - Threads for facepieces - Part 1: Standard thread connection</i>	SSH EN 148-1:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Filetat për maskat e fytyrës - Pjesa 1: Bashkimet me fileta standarde.	2002	FP
53	<i>EN 148-2:1999 Respiratory protective devices - Threads for facepieces - Part 2: Centre thread connection</i>	SSH EN 148-2:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Filetat për maskat e fytyrës - Pjesa 2: Bashkimet me fileta qendrore.	2002	FP
54	<i>EN 148-3:1999 Respiratory protective devices - Threads for facepieces - Part 3: Tread connection M 45 x 3</i>	SSH EN 148-3:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes - Filetat për maskat e fytyrës - Pjesa 3: Bashkimet me fileta M 45x3.	2002	FP
55	<i>EN 149:2001+A1:2009 Respiratory protective devices - Filtering half masks to protect against particles - Requirements, testing, marking</i>	SSH EN 149:2001+A1:2009 Pajisje mbrojtëse respiratore - Gjysmëmaskat e filtrimit për mbrojtjen nga grimcat - Kërkesat, prova dhe markimi.	2009	FP
56	<i>EN 166:2001 Personal eye-protection - Specifications</i>	SSH EN 166:2001 Mbrojtja vetjake e syve - Specifikime.	2007	FP
57	<i>EN 169:2002 Personal eye-protection - Filters for welding and related techniques - Transmittance requirements and recommended use</i>	SSH EN 169:2002 Mbrojtja vetjake e syve - Filtrat për saldimin dhe teknikat që kanë të bëjnë me to - Kërkesat për përçueshmërinë dhe përdorimi i rekomanduar.	2007	FP
58	<i>EN 170:2002 Personal eye-protection - Ultraviolet filters - Transmittance requirements and recommended use</i>	SSH EN 170:2002 Mbrojtja vetjake e syve - Filtrat ultravioletë - Kërkesat për transmetueshmërinë dhe përdorimi i rekomanduar.	2007	FP
59	<i>EN 172:1994 Personal eye protection - Sunglare filters for industrial use</i>	SSH EN 172:1994 Mbrojtja vetjake e syve - Filtrat për mbrojtjen nga dielli për përdorim industrial.	2004	FP
60	<i>EN 172:1994/A1:2000</i>	SSH EN 172:1994/A1:2000	2006	FP
61	<i>EN 172:1994/A2:2001</i>	SSH EN 172:1994/A2:2001	2011	FP
62	<i>EN 174:2001 Personal eye-protection - Ski goggles for downhill skiing</i>	SSH EN 174:2002 Mbrojtja vetjake e syve - Syze për skiatorë për zbritje nga lartësia.	2007	FP
63	<i>EN 175:1997</i>	SSH EN 175:2000 Mbrojtja personale - Pajisjet për mbrojtjen e syve dhe të fytyrës	2000	FP

	<i>Personal protection - Equipment for eye and face protection during welding and allied processes</i>	gjatë saldimit dhe proceseve të ngjashme me to.		
64	EN 207:2017 <i>Personal eye-protection equipment - Filters and eye-protectors against laser radiation (laser eye-protectors)</i>	SSH EN 207:2017 Pajisje mbrojtëse personale e syve - Filtrat dhe mbrojtëset e syve nga rrezatimi lazer (syze mbrojtëse lazer).	2017	FP
65	EN 208:2009 <i>Personal eye-protection - Eye-protectors for adjustment work on lasers and laser systems (laser adjustment eye-protectors)</i>	SSH EN 208:2009 Mbrojtja vetjake e syve - Mbrojtëset e syve për punë riparuese me lazer dhe me sisteme lazeri.	2009	FP
66	EN 250:2014 <i>Respiratory equipment - Open-circuit self-contained compressed air diving apparatus - Requirements, testing and marking</i>	SSH EN 250:2014 Pajisje të frymëmarrjes - Aparate zhytëse me ajër të ngjeshur të pavarura me qark të hapur - Kërkesat, provat dhe markimi.	2014	FP
67	EN 342:2017 <i>Protective clothing - Ensembles and garments for protection against cold</i>	SSH EN 342:2017 Veshje mbrojtëse - Komplete dhe veshje për mbrojtjen ndaj të ftohtit.	2018	FP
68	EN 343:2003+A1:2007	SSH EN 343:2003+A1:2007	2010	FP
69	EN 343:2003+A1:2007/AC:2009	SSH EN 343:2003+A1:2007/AC:2009	2010	FP
70	EN 352-1:2002 <i>Hearing protectors - General requirements - Part 1: Ear-Muffs</i>	SSH EN 352-1:2002 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 1: Kufjet e veshëve.	2007	FP
71	EN 352-2:2002 <i>Hearing protectors - General requirements - Part 2: Ear-plugs</i>	SSH EN 352-2:2002 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 2: Kufjet spine. Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 2: Kufjet spine.	2007	FP
72	EN 352-3:2002 <i>Hearing protectors - General requirements - Part 3: Ear-muffs attached to an industrial safety helmet</i>	SSH EN 352-3:2002 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 3: Kufjet e veshëve të bashkuara në një helmetë sigurie industriale.	2007	FP
73	EN 352-4:2001 <i>Hearing protectors - Safety requirements and testing - Part 4: Level-dependent ear-muffs</i>	SSH EN 352-4:2001 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 4: Kufjet e veshëve me dëgjim që varet nga niveli.	2011	FP
74	EN 352-4:2001/A1:2005	SSH EN 352-4:2001/A1:2005	2014	FP
75	EN 352-5:2002 <i>Hearing protectors - Safety requirements and testing - Part 5: Active noise reduction ear-muffs</i>	SSH EN 352-5:2004 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 5: Kufjet e veshëve për pakësimin e zhurmës aktive.	2004	Fp
76	EN 352-5:2002/A1:2005	SSH EN 352-5:2002/A1:2005	2014	FP
77	EN 352-6:2002 <i>Hearing protectors - Safety requirements and testing - Part 6: Ear-muffs with electrical audio input</i>	SSH EN 352-6:2004 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 6: Kufjet e veshëve me hyrje audioelektrike.	2004	FP
78	EN 352-7:2002 <i>Hearing protectors - Safety requirements and testing - Part 7: Level-dependent ear-plugs</i>	SSH EN 352-7:2004 Mbrojtësit e dëgjimit - Kërkesat për sigurinë dhe provat - Pjesa 7: Kufjet spine që varen nga niveli.	2004	FP

79	<i>EN 352-8:2008 Hearing protectors - Safety requirements and testing - Part 8: Entertainment audio ear-muffs</i>	SSH EN 352-8:2008 Mbrojtëse individuale për mbrojtjen e dëgjimit - Kërkesat e sigurisë dhe të provës - Pjesa 8: Kufje veshi me mundësi dëgjimi audio që nuk ka lidhje me punën.	2010	FP
80	<i>EN 353-1:2014+A1:2017 Personal fall protection equipment - Guided type fall arresters including an anchor line - Part 1: Guided type fall arresters including a rigid anchor line</i>	SSH EN 353-1:2014+A1:2017 Pajisje mbrojtëse personale gjatë rënies nga lartësia - Tipa të kontrolluara pajisjesh kapëse të rënies, që kanë një ganxhë ankoruese - Pjesa 1: Tipa të kontrolluara pajisjesh kapëse të rënies që kanë një ganxhë ankoruese të ngurtë, të papërkulshme.	2018	FP
81	<i>EN 353-2:2002 Personal protective equipment against falls from a height - Part 2: Guided type fall arresters including a flexible anchor line</i>	SSH EN 353-2:2002 Pajisjet mbrojtëse personale kundra rënies nga një lartësi - Pjesa 2: Bllokuesit e lëvizshëm që përmbajnë një suport sigurie fleksibël.	2012	FP
82	<i>EN 354:2010 Personal fall protection equipment - Lanyards</i>	SSH EN 354:2010 Pajisjet mbrojtëse personale nga rëniet nga lartësia - Nyjat (laqet).	2011	FP
83	<i>EN 355:2002 Personal protective equipment against falls from a height - Energy absorbers</i>	SSH EN 355:2002 Pajisjet mbrojtëse personale nga rëniet nga lartësia - Absorbuesit e energjisë.	2007	FP
84	<i>EN 358:1999 Personal protective equipment for work positioning and prevention of falls from a height - Belts for work positioning and restraint and work positioning lanyards</i>	SSH EN 358:1999 Pajisje mbrojtëse personale për pozicionim gjatë punës dhe për parandalimin e rënies nga lartësia - Rripat për pozicionimin gjatë punës dhe frenuesit e nyjave për pozicionimin gjatë punës.	2006	FP
85	<i>EN 358:2018 Personal protective equipment for work positioning and prevention of falls from a height - Belts and lanyards for work positioning or restraint</i>	SSH EN 358:2018 Pajisje mbrojtëse personale për pozicionim gjatë punës dhe për parandalimin e rënies nga lartësia - Rripat dhe litarët e kontrollit për pozicionimin gjatë punës.	2019	FP
86	<i>EN 360:2002 Personal protective equipment against falls from a height - Retractable type fall arresters</i>	SSH EN 360:2002 Pajisje mbrojtëse personale kundra rënies nga një lartësi - Bllokuesit automatik të rënies.	2007	FP
87	<i>EN 361:2002 Personal protective equipment against falls from a height - Full body harnesses</i>	SSH EN 361:2002 Pajisje mbrojtëse personale kundra rënies nga një lartësi - Ripa lidhës të trupit.	2003	FP
88	<i>EN 362:2004 Personal protective equipment against falls from a height - Connectors</i>	SSH EN 362:2004 Pajisje mbrojtëse personale kundra rënies nga lartësia - Lidhëset.	2007	FP
89	<i>EN 365:2004 Personal protective equipment against falls from a height - General requirements for instructions for use, maintenance, periodic examination, repair, marking and packaging</i>	SSH EN 365:2004 Pajisje mbrojtëse personale kundra rënies nga një lartësi - Kërkesa të përgjithshme për instruksionet e përdorimit, mirëmbajtjes, ekzaminimit periodik, riparimit, markimit dhe paketimit.	2012	FP
90	<i>EN 365:2004/AC:2006</i>	SSH EN 365:2004/AC:2006	2014	FP
91	<i>EN ISO 374-1:2016</i>	SSH EN ISO 374-1:2016	2017	FP

	<i>Protective gloves against dangerous chemicals and micro-organisms - Part 1: Terminology and performance requirements for chemical risks (ISO 374-1:2016)</i>	Doreza mbrojtëse ndaj kimikateve dhe mikroorganizmave të rrezikshme - Pjesa 1: Terminologjia dhe kërkesat e performancës për rreziqet kimike (ISO 374-1:2016).		
92	<i>EN ISO 374-5:2016 Protective gloves against dangerous chemicals and micro-organisms - Part 5: Terminology and performance requirements for micro-organisms risks (ISO 374-5:2016)</i>	SSH EN ISO 374-5:2016 Doreza mbrojtëse kimikateve dhe mikroorganizmave të rrezikshme - Pjesa 5: Terminologjia dhe kërkesat e performancës për rreziqet ndaj mikroorganizmave (ISO 374-5:2016).	2017	FP
